



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Monitorimi i prokurimit publik në pesë komuna: Gjakovë, Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Pejë

Dhjetor
2022





QEVERISJE E MIRË

AUTORË:

Ardit Dragusha

Egzona Kozhani



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy Plus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Ky raport është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti "Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar" i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
Përmbledhje e të gjeturave	7
Komuna e Gjakovës	10
Marrja në shfrytëzim e pajisjeve për dezinfektimin e duarve me dezinfektant	10
Furnizimi dhe mirëmbajtja me “smart city” kamera publike, shtylla multifunkionale dhe pajisje tjera.....	13
Furnizimi me material higjenik për shkolla	14
Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative.....	16
Komuna e Prishtinës	18
Zbatimi i platformës online për digjitalizim të shkollave (E-shkollori).....	18
Furnizimi i testeve të shpejta antigjen me pështymë.....	20
Sigurimi fizik i objekteve të komunës	21
Trajtimi i kafshëve endacake	22
Komuna e Prizrenit	24
Furnizim me material stomatologjik.....	24
Vetëdijesimi i nxënësve të shkollave fillore dhe vozitëse në Komunën e Prizrenit për sjellje në trafik.....	25
Furnizimi me inventar për zyrë dhe ordianca shëndetësore	27
Organizimi i festivalit të këngës së vjetër Zambaku i Prizrenit 2022	28
Komuna e Gjilanit.....	31
Pastrimi i objekteve shkollore.....	31
Trajtimi i qenve endacak	35
Dezinsektimi hapësinor, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve në komunën e Gjilanit - ritender.....	39
Asfaltimi i rrugës në lagjen Arbëria.....	40
Komuna e Pejës	42
Ndriçimi dhe kubëzimi i hapësirave publike në komunën e Pejës - pjesa II.....	42
Blerja e moto kultivatorëve	50
Ndërtimi i hapësirave publike përreth QKMF-së	52
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në komunë.....	54
6. Rekomandime.....	56

Lista e shkurtesave

AUV	➤ Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AQP	➤ Agjencia Qendrore e Prokurimit
AK	➤ Autoritet Kontraktues
ARBK	➤ Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ATK	➤ Administrata Tatimore e Kosovës
DT	➤ Dosja e Tenderit
GEO	➤ Grupi i Operatorëve Ekonomikë
KRPP	➤ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	➤ Ligji për Prokurim Publik
OE	➤ Operator Ekonomik
OShP	➤ Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKMF	➤ Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
RrUOPP	➤ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

Përmbledhje e të gjeturave

- Institucionet publike kanë vendosur kritere diskriminuese të cilat kanë dëmtuar konkurrencën dhe kanë dërguar në uljen e numrit të ofertuesve.
- Institucionet publike kanë shpërblyer me kontratë operatorët ekonomikë të cilët nuk i kanë përmbushur kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit.
- Pavarësisht se institucionet janë bazuar në dispozita të caktuara ligjore për marrjen e një veprimi, të njëjtat dispozita nuk janë respektuar në tërësi.
- Komisionet e vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale ofertat e operatorëve ekonomikë.
- Pavarësisht se ekziston mundësia që të lidhen kontrata më të favorshme në raport me përdorimin ekonomik të parasë publike, institucionet publike lidhin kontrata me çmime të larta apo lidhin kontrata të cilat nuk i shërbejnë interesit publik.
- Në Dosjen e Tenderit, institucionet publike nuk paraqesin qartë dhe ligjshëm kërkesat që duhet të plotësohen nga operatorët e interesuar, që i krijon operatorëve ofertues mundësi për manipulime dhe shmangie nga këto kërkesa.
- Institucionet publike vazhdojnë të përdorin procedurën e negociuar pa publikim të kontratës pavarësisht se nuk plotësohen kërkesat ligjore për përdorimin e kësaj procedure.
- Edhe pse planet vjetore të prokurimit hartohen dhe aprovohen sipas hapave të përcaktuara me ligj, këto plane nuk respektohen nga institucionet publike dhe më pas krijojnë probleme zingjirore në prokurim.
- Për shkak të mos respektimit të kritereve për përdorim të procedurave të caktuara, institucionet publike kanë lidhur kontrata me vlera më të larta ngase nuk janë deponuar oferta të mjaftueshme.
- Si pasojë e mos emërimit të anëtarëve të rinj të bordit të OShP-së, institucionet publike me qëllim që të realizojnë projektet, janë detyruar që të marrin veprime që nuk janë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.
- Institucionet publike lidhin kontrata me operatorë të ndryshëm ekonomikë të cilët nuk janë të profilizuar në kryerjen e atyre shërbimeve.
- Si pasojë e mos hartimit preciz të paramasës nga ana e institucioneve publike, operatorët ekonomikë kanë shfrytëzuar mundësitë të përfitojnë përmes vendosjes së çmimeve të ndryshme për punë apo furnizime të njëjta.
- Institucionet publike nuk aplikojnë të drejtën për ndarjen e përgjegjësive të përmbushjes së kërkesave nga ana e anëtarëve të grupit të operatorëve ekonomikë.

- Institucionet publike vazhdojnë të pranojnë fatura nga operatorët ekonomikë në të cilat nuk identifikohet saktë çfarë është blerë, në çfarë sasi dhe në çfarë çmimi. Në mënyrë që të evitohet mundësia që operatorët të manipulojnë me çmime dhe sasi të produkteve, institucionet duhet të obligojnë të njëjtit që të përshkruajnë saktësisht produktet që kanë blerë dhe tu përmbahen çmimeve të vendosura në paramasë.

Komuna e Gjakovës

- Ka ulur konkurrencën duke vendosur kërkesën për një ISO standard i cili nuk ka qenë relevant për përmbushjen e kontratës.
- Ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik i cili nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me stafin profesional, të cilët do të angazhoheshin për realizimin e kontratës.
- Nuk ka kërkuar sqarime shitesë për mungesën e certifikatës së TVSh-së, dhe kundërligjshëm duke u bazuar në këtë mungesë, ka refuzuar ofertën në tërësi.
- Fillimisht ka nënshkruar kontratën, ndërsa të njëjtën e ka anuluar pasi me vonesë janë vërejtur gabimet që kanë dërguar deri në anulimin e kontratës.
- Nuk ka ndërmarrë hapa në raport me vazhdimin e validitetit të ofertës, që ka dërguar në anulim të kontratës.

Komuna e Prishtinës

- Në vitin 2021 dhe 2022 ka vazhduar lidhjen e kontratës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke e rritur vlerën e kontratës nga viti në vit pavarësisht se platforma e kontraktuar më nuk përdorej dhe njëjta nuk funksiononte mirë edhe në kohën kur përdorej.
- Ka lidhur kontratën edhe pse nënshkrimin e deklaratën nën betim nuk e ka bërë as pronari i kompanisë dhe as personi i autorizuar nga kompania, veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.
- Ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për tu furnizuar me teste të shpejta antigjen, edhe pse një kontratë e tillë ka mund të zhvillohej me procedurë të hapur ngase nuk ka ekzistuar ndonjë urgjencë që kërkon përdorimin e kësaj procedure.
- Si rezultat i përdorimit të procedurës së negociuar ka paguar produkte me çmime më të larta se ato të tregut.
- Me arsyetimin se kontrata për sigurim fizik të objektit të komunës ka ngecur në OShP në mungesë të bordit, ka zhvilluar aktivitetet të ri të prokurimit duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Komuna e Prizrenit

- Lidhi kontratë me operatorin ekonomik për të cilin kishte bërë kërkesë në OShP për diskualifikim, mirëpo për shkak se OShP ishte pa bord nuk është marrë ndonjë vendim në këtë drejtim, mosveprim i cili kishte dërguar në lidhjen e kësaj kontrate me këtë operator.
- Kishte lidhur kontratë për vetëdijesimin e nxënësve dhe vozitësve për sjellje në trafik, me një kompani e cila për aktivitet kishte pastrimin e hapësirave të ndryshme.
- Nuk ka përdorur të drejtën e saj për të kërkuar informacione shtesë lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta, kështu duke injoruar ekzistimin e kësaj gjendje dhe me këto çmime ka lidhur kontratë me operatorin ofertues, vlera e ofertës të të cilit ishte 64.14% më e ulët se mesatarja e tenderëve të përgjegjshëm.
- Si pasojë e vlerësimit të gabuar të ofertave, vonoi mbajtjen e edicionit të 33-të të festivalit “Zambaku i Prizrenit”, mbajtja e të cilit u shty për pesë muaj të tjerë.

Komuna e Gjilanit

- Duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, lidhi dy kontrata me të njëjtin grup të operatorëve ekonomikë me qëllim pastrimin e objekteve shkollore, pavarësisht se aktivitetet të tilla ishin planifikuar me planin vjetor të prokurimit.
- Lidhi kontratën me operatorin ekonomik, i cili dorëzoi paramasën në të cilën figurojnë pagesat neto të punëtorëve duke injoruar në tërësi barrën për pagesën e tatimeve që zbriten nga paga bruto. Për tu përmbushur ky obligim ligjor nuk është kujdesur as komuna e as operatori i shpërblyer me kontratë.

- Shkurtoi afatin për dorëzim të ofertave për tenderin që kishte të bëjë me trajtimin e qenve endacak, pa dhënë ndonjë sqarim i cili do të krijonte bazë ligjore për një veprim të tillë.

Komuna e Pejës

- Nuk ka vlerësuar drejtë ofertën e operatorit ekonomik të cilin fillimisht e shpalli fitues, ndërsa më vonë vërejtë se gabimet aritmetike kalojnë 2% të shumës së lejuar, e që rezultoi në anulimin e njoftimit për kontratë duke vonuar realizimin e projektit.
- Si pasojë e mos identifikimit të saktë të nevojave ka hartuar paramasë të përgjithësuar në të cilën i njëjti operator ka vendosur çmime të ndryshme për të njëjtat punë dhe produkte.
- Përdori standarde të dyfishta lidhur me vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë ofertues. Nga gara ka përjashtuar katër operatorë ekonomikë për shkak se nuk kishin plotësuar kërkesën lidhur me katalogun e kërkuar, mirëpo as operatori i shpallur fitues nuk kishte përmbushur këtë kërkesë.

- Nuk ka ndërmarrë asnjë masë ndaj operatorit i cili vonoi përfundimin e kontratës për pothuajse një vit, e as menaxheri i kontratës nuk ka bërë raportime të rregullta lidhur me këto vonesa.



Komuna e Gjakovës

Marrja në shfrytëzim e pajisjeve për dezinfektimin e duarve me dezinfektant

Komuna e Gjakovës në fund të vitit 2021, shpalli njoftimin për kontratë për marrjen në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për dezinfektimin e duarve me dezinfektant, me numër të prokurimit 632-21-10207-1-2-1. Ky aktivitet i prokurimit me vlerë të parashikuar të kontratës 51,324.00 euro, kishte për qëllim marrjen në shfrytëzim të 91 pajisjeve me sensor për dezinfektimin e duarve me dezinfektant për 12 muaj, pajisje këto të cilat do të vendoseshin në objektet e shkollave të Komunës së Gjakovës.

Komuna e Gjakovës kishte pasur edhe më herët kontratë të njëjtë për marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve (05.11.2020 – 04.11.2021), të cilën e kishte lidhur me konsorciumin N.Sh Alb Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K në vlerë prej 49,140.00 euro. Edhe pse në të dy tenderët është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar e të cilëve është 98,280.00 euro, vetëm një ofertues (N.Sh Alb Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K) mori pjesë dhe në të dyja rastet i njëjti u shpërblye me kontratë. Një nga arsytet që mund të ketë çuar në këtë zvogëlim të konkurrencës është kërkesa teknike në Dosjen e Tenderit, që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencë ISO 22716 – praktikat e mira të prodhimit.

ISO 22716 është certifikim i cili ofron udhëzime për prodhimin, kontrollin, ruajtjen dhe dërgimin e produkteve kozmetike. Ky standard është i natyrës udhëzuese për produktet kozmetike, dhe i njëjti nuk vlen për shpërndarjen e produkteve të gatshme¹. Me qëllim që të sigurojë konkurrencën mes operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të kontraktojë çmime më të lira, komuna nuk është dashur të vendosë këtë kriter i cili nuk ka qenë relevant për produktet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, dhe i njëjti ka mundur të zëvendësohet me dëshmi tjera që garantojnë cilësinë por nuk eliminojnë konkurrencën.

Në aktivitete të ngjashme të prokurimit që kishin qëllim marrjen në shfrytëzim të pajisjeve dezinfektuese, të administruar nga autoritet tjera kontraktuese (shih tabelën 1), është vërejtur se vendosja e këtij kriteri ka kufizuar konkurrencën. Në rastet e përzgjedhura ku është kërkuar certifikata ISO 22716, ka ofertuar vetëm një (1) operator ekonomik ndërkohë mesatarja në Kosovë është 4.5 operatorë ekonomikë për një aktivitet të prokurimit publik².

1 ISO 22716:2007. Cosmetics – Good Manufacturing Practices (GMP) – Guidelines on Good Manufacturing Practices. <https://www.iso.org/standard/36437.html> (qasur për herë të fundit me 07.11.2022).

2 Raporti mbi aktivitetin e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2021. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%20i%20aktiviteteve%20te%20prokurimit%20-%202021.pdf> (qasur për herë të fundit me 07.11.2022).

Në tenderin e natyrës së njëjtë, ku nuk ishte vendosur ky kriter dhe në vend tij u kërkuar dëshmi që ofertuesit të kenë përfunduar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit, morën pjesë katër operatorë ekonomikë, dhe u kontraktua çmimi për 30% më i lirë sesa që ishte në vlerën e parashikuar.

TABELA 1. Krahasimi i aktiviteteve të prokurimit për marrjen në shfrytëzim të aparateve për dezinfektim në rastet kur është kërkuar ISO 22716 dhe në rastin kur nuk është kërkuar kjo certifikatë

Autoriteti kontraktues	Nr. i prokurimit	A është kërkuar ISO 22716?	Nr. i ofertave të pranuar	Operatori ekonomik fitues
Universiteti Haxhi Zeka	uhz-21-7798-2-3-6	Po	1	N.Sh. Alb Consulting; Fresh-C.O
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	209-20-7952-2-3-6	Po	1	N.Sh. Alb Consulting; Fresh-C.O
Komuna e Gjakovës (2020)	632-20-5759-1-2-1	Po	1	N.Sh. Alb Consulting; Fresh-C.O
Komuna e Gjakovës (2021)	632-21-156-1-2-1	Po	1	N.Sh. Alb Consulting; Fresh-C.O
Gjykata Kushtetuese	243238-22-2270-2-2-1	Jo	4	S.V., Veterina

Përveç vendosjes së ISO certifikatës që pengoi konkurrencën, problematike është edhe vetë natyra e tenderit. Kjo pasi vlera e përgjithshme indikative e dy kontratave është 98,280.00 euro, me konsorciumin fitues që obligohet të bëjë vendosjen e këtyre pajisjeve në shkollat e Komunës së Gjakovës, QKMF, Drejtorinë e Arsimit dhe të bëjë mbushjen me dezinfektant për shfrytëzim mujor për 24 muaj.

Sipas kontratës, 91 pajisjet do të paguhen nga 45.00 euro për njësi, për 12 muaj (24 muaj duke llogaritur edhe kontratën paraprake), dhe më pastaj këto pajisje do u kthehen operatorëve ekonomikë.

TABELA 2. Dy kontratat kornizë të lidhura mes Komunës së Gjakovës dhe N.Sh Alba Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K.

Viti	Çmimi mujor për një pajisje	Vlera totale e kontratës	Kohëzgjatja
2020	45.00 euro	49,140.00 euro	12 muaj
2021	45.00 euro	49,140.00 euro	12 muaj

Në këtë aktivitet të prokurimit ka mungesë të madhe të transparencës duke qenë se nuk është bërë dallimi mes çmimit të shfrytëzimit të pajisjeve dhe çmimit për furnizim me material shpenzuese për këto pajisje. Këto dy elemente të cilat duhet të jenë të ndara, janë njësuar në paramasë dhe për të dyja është ofruar vetëm një çmim, i cili është aplikuar pastaj për 91 pajisje për 12 muaj.

TABELA 3. Paramasa për marrjen në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për dezinfektimin e duarve me dezinfektant

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Muaj	Çmimi njësi me TVSh	Çmimi total me TVSh
1.	Sigurimi dhe montimi i spërkatësit me sensor për dezinfektimin e duarve me mbushje permanente të pajisjes me dezinfektant për shfrytëzim mujor. Spërkatës automatik duhet të ketë kapacitet 1000ml.	copë	91	12	/	/

Kjo formë e përgjithësimi të furnizimit lë hapësirë për manipulim, pasi askund nuk tregohet sasia (litra) e materialit dezinfektues, çmimit të cilit do të paguhet për këtë material që është shfrytëzuar apo kostoja e mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve. Sasia e furnizimit nuk tregohet as në raportet e menaxherit dhe as në fatura të cilat janë paguar nga Komuna e Gjakovës, e cila ka bërë pagesa bazuar në çmimin e kontraktuar me kontratë për njësi, pavarësisht sasisë së materialit që mund të jetë shfrytëzuar.

Në total, një pajisje për dezinfektimin e duarve i ka kushtuar Komunës së Gjakovës 1,080.00 euro për 24 muaj (540 euro në vit). Sipas menaxherit të kontratës, këto pajisje kanë pasur furnizim “pa limit” i cili është bërë në varësi të kërkesave të shkollave, ku mesatarisht janë mbushur dy herë në muaj. Ky furnizim nuk arsyeton çmimin e lartë të pajisjeve pasi një (1) litër e materialit dezinfektues për duar kushton nga dy (2) deri në pesë (5) euro³ me pakicë. Komuna e Gjakovës është dashur të bëjë blerjen e këtyre pajisjeve, vlera e të cilave në treg varion nga 16 deri në 100 euro për njësi, për një kosto totale më pak se 10 mijë euro në vend se të lidhë dy kontrata për marrjen në shfrytëzim dhe furnizim të këtyre pajisjeve për një kosto totale rreth 100 mijë euro.

Një tjetër anomali në këtë aktivitet të prokurimit është caktimi i drejtorit të një shkollë të Gjakovës si menaxher i kontratës nga Zyrtari Kryesor Financiar. Në të gjitha raportet e komisioneve për mbikëqyrjen e kontratës, të cilat bëhen pas pranimit të furnizimit kërkohej nënshkrimi i menaxherit të kontratës, që në këtë rast ishte drejtori i shkollës “Yll Morina”, dhe në anën tjetër, nënshkrimet e anëtarëve të komisionit pranues të shkollës respektive, në krye me drejtorin e shkollës dhe dy anëtarëve të tjerë.

Në këtë situatë, menaxheri i kontratës nënshkruante dy anët e raportit të mbikëqyrjes. Në njërin anë si menaxher i kontratës, ndërkohë në anën tjetër si anëtarë i komisionit në shkollë.

3 Oferta për dezinfektues të duarve nga kompania Fresh Co, Pejë.

Furnizimi dhe mirëmbajtja me “smart city” kamera publike, shtylla multifunksionale dhe pajisje tjera

Komuna e Gjakovës në dhjetor të vitit 2021, nënshkroi kontratën publike për furnizim dhe mirëmbajtje me “smart city” kamera publike, shtylla multifunksionale dhe pajisje tjera (faza IV) me numër të prokurimit 632-21-3045-1-1-1. Dy operatorë ekonomikë morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit që kishte vlerë të parashikuar 219,630.00 euro, teksa kontrata iu dha Ati-Kos Sh.P.K., që ofertoj me 218,910.00 apo 720 euro më pak sesa vlera e parashikuar.

TABELA 4. Ofertat e operatorëve ekonomikë që morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	Ati – Kos Sh.P.K.	218,910.00 euro
2.	Grupi i OE Komtel Project Engineering Sh.P.K.; Kujtesa Net Sh.P.K.; Panamic ICT L.L.C	174,413.00 euro

Para dorëzimit të ofertave, grupi i OE-ve Komtel Project Engineering Sh.P.K.; Kujtesa Net Sh.P.K.; Panamic ICT L.L.C (tutje Komtel et al.), kishte bërë një kërkesë për rishqyrtimin e Dosjes së Tenderit, me pretendimin se specifikimet teknike kishin karakter diskriminues dhe favorizonin një prodhues specifik.

Komuna e Gjakovës aprovoi pjesërisht këtë kërkesë, duke dhënë sqarime shtesë mbi pajisjet dhe versionet e softuerëve të kërkuar, por kërkesa që ky tender të ndahej në Lot-e pasi punët nuk ishin të natyrës së njëjtë (shtrimi i rrjetit fibër, furnizimi/instalimi i kamerave) u refuzua me arsyetimin që projektet e tilla janë të suksesshme kur kompanitë ofrojnë të gjitha shërbimet dhe për çdo problem komunikohet vetëm me një kompani⁴.

Kompania Ati- Kos Sh.P.K, u shpërblye me kontratë si ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm, pasi oferta e Komtel et al., u vlerësua se nuk kishin plotësuar disa kërkesa. Një nga arsyet se pse Komtel et al. u eliminua kishte të bënte me mosplotësimin e kërkesës për kualifikim të stafit, konkretisht prezantimin e vetëm dy (2) diplomave universitare për A.L dhe D.Sh, ndërkohë A.G nuk kishte dorëzuar diplomën por vetëm CISCO certifikatën.

Në Dosjen e Tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale specifikohesh që operatori ekonomik të ofronte dëshmi që kishte të angazhuar:

- dy (2) inxhinierë të diplomuar ose master të elektroteknikës;
- dy (2) inxhinierë të diplomuar ose master të rrjetave telekomunikuse.

Dëshmitë e kërkuara për këtë pjesë ishin “Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV (origjinal e nënshkruar nga inxhinieri), diploma, certifikata, kontrata e punës me ofertuesin.

⁴ Sqarimi shtesë në Dosjen e Tenderit e përgatitur me datën 21.05.2021.

Megjithatë edhe Ati-Kos Sh.P.K., me të cilin Komuna e Gjakovës lidhi kontratën nuk e kishte plotësuar këtë kërkesë. Në ofertën Ati-Kos Sh.P.K., figurojnë dy inxhinierë të elektroteknikës F.S dhe Z.P, për të cilët janë dorëzuar diplomat universitare, por për dy inxhinierët e tjerë të rrjetave telekomunikuese, janë dorëzuar vetëm certifikatat për e CCNA (Cisco Certified Network Associate) dhe Panduit Installer Program – Copper and Fiber.

Certifikatat CISCO nuk përmbushin kërkesën e vendosur nga Komuna e Gjakovës në DT për “inxhinierë të diplomuar ose master të rrjetave telekomunikuese”, pasi nuk janë kualifikime universitare. Në raportin e komisionit vlerësues, ku rekomandohet dhënia e tenderit për Ati – Kos Sh.P.K thuhet se “pas vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, komisioni konstatoi se si operator ekonomik më i përgjegjshëm me çmimin më të ulët është Ati-Kos Sh.P.K.,”.

Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme, të cilat tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm⁵. Ashtu siç kishte konstatuar se certifikatat CISCO nuk plotësojnë kërkesat te oferta e Komtel et.al, Komuna e Gjakovës është dashur të eliminojë edhe Ati-Kos Sh.P.K., duke qenë se bëhet fjalë për shkelje të njëjtë dhe lidhja e kontratës me këtë operator ekonomik paraqet shkelje të rregullave të prokurimit publik. Nuk mund të thuhet operator “më i përgjegjshëm” pasi ofertat pranohen vetëm kur ato janë të përgjegjshme.

Një tjetër dokument në ofertën e operatorit ekonomik fitues, për të cilën komuna është dashur të kërkoj sqarime shtesë është hasur te kontratat e punës së stafit të angazhuar. Në kontratën e parë, Ati-Kos Sh.P.K., është përfaqësuar nga Z.P, i cili ka lidhur kontratë pune me F.S, ndërkohë në kontratën e dytë, Ati Kos Sh.P.K., është përfaqësuar nga F.S, i cili ka lidhur kontratë pune me Z.P. Të dy këto kontrata janë lidhur me datën e njëjtë, 01.02.2011.

Furnizimi me material higjenik për shkolla

Komuna e Gjakovës në qershor të vitit 2022 shpalli njoftimin për kontratë për furnizim me material higjenik për shkolla në vlerë të parashikuar të kontratës 45,040.00 euro. Ky tender me numër të prokurimit 632-22-5530-1-2-1, kishte për qëllim blerjen e detergjenteve për pastrim, fshesave, sapunëve, thasëve për mbeturina të biodegradueshme dhe materialeve të tjera higjienike për objektet e shkollave në Komunën e Gjakovës.

Edhe në këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Gjakovës vendosi kriterin për produktet të kozmetikës GMP ISO 22716, ndonëse bëhej fjalë për furnizim me materiale higjienike. Pas rekomandimit të KRPP-së, të datës 17.06.2022, komuna e zëvendësoi këtë kriter me certifikatën ISO 90001 – 2018 menaxhimi i cilësisë së mirë. Tre operatorë ekonomikë dorëzuan oferta me autoritetin kontraktues që aplikoi procedurën e hapur, ndërkohë kriter i dhënies së kontratës u caktua tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik. Neni 20.0. Janar, 2021. <https://kk.rks-gov.net/shterpce/wp-content/uploads/sites/29/2022/04/A01-Rregullat-dhe-Udhezuesi-Operativ-per-Prokurimin-Publik.pdf> (qasur për herë të fundit me 11.11.2022).

TABELA 5. Ofertat e operatorëve ekonomikë që morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Emri i operatorëve ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1	Grupi i OE PM Group Sh.P.K.; Ramadan Gërzhaliu	25,738.10 euro
2	Grupi i OE N.Sh Alb Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K	39,616.00 euro
3	KIGA Sh.P.K	37,777.50 euro

Nga tri ofertat e dorëzuara, dy u refuzuan me arsyetimin se deklaratat e konformitetit nga prodhuesit nuk plotësonin kushtet e Dosjes së Tenderit, dhe se njërit nga ofertuesit i mungonte certifikata e TVSH-së. Për kontratë u rekomandua konsorciumi N.Sh Alb Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K., të cilët kishin çmimin më të lartë nga të tre ofertuesit.

Ndaj këtij vendimi, PM Group Sh.P.K., parashtrroi kërkesë për ri-shqyrtim me pretendimin se Komuna e Gjakovës nuk respektoi nenin 39 të RrOUPP në momentin kur nuk pranoi deklaratën e konformitetit të cilën ata e kishin plotësuar, dhe nuk kërkoi sqarim shtesë lidhur me mungesën e certifikatës së TVSH-së. Komuna e Gjakovës, konkretisht Njësia e Prokurimit, e refuzoi këtë kërkesë me arsyetimin se sipas nenit 72 të LPP-së, në rastet kur një operator ekonomik nuk plotëson një nga kërkesat e DT-së, nuk kërkohen sqarime shtesë dhe tenderi refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Në fakt, neni 72 i LPP-së⁶, të cilit i është referuar Komuna e Gjakovës, iu mundëson autoriteteve kontraktuese të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë. Edhe neni 39 i RrUOPP, në mënyrë të detajuar jep udhëzime se si duhet vepruar në rastin kur mungon certifikata e TVSH, duke sqaruar se autoriteti kontraktues duhet t'i dërgojë operatorit ekonomik i cili nuk ka kompletuar dokumentacionin "Kërkesë për sqarim të tenderit" përmes sistemit elektronik.

TABELA 6. Neni 39.8 i RrUOPP-së, i cili në varësi të rastit të paraqitur i udhëzon autoritetet kontraktuese si të veprojnë

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	66

Arsyeja e dytë për eliminimin e ofertuesit, ishte se deklarata e prezantuar e konformitetit nga prodhuesi ishte e mangët – e përgjithësuar dhe nuk ishte prezantuar siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

Edhe ky pretendim nuk qëndron për faktin se ofertuesit kishin prezantuar deklaratën e konformitetit duke plotësuar këtë kërkesë teknike. Kompania Ramadan Gërzhaliu B.l., e cila ishte pjesë e këtij konsor-

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurimin Publik. Neni 72.

ciumi, në bazë të regjistrimit në ARBK është prodhuese e materialeve higjienike dhe veprimtari kryesore ka “prodhimin e sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit”. Rrjedhimisht, deklarata e konformitetit e dorëzuar nga ky konsorcium është e vlefshme dhe duhej pranuar. Duke qenë se të dy kushtet ishin plotësuar nga PM Group Sh.P.K.; Ramadan Gërxhaliu B.I dhe oferta e tyre ishte për 13,878.00 euro më e lirë se oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë, Komuna e Gjakovës është dashur të pranojë këtë ofertë dhe ta shpërblejë me kontratë si ofertuesi me çmimin më të lirë.

Vendim për shpërbllim me kontratë të N.Sh Alb Consulting; Fresh – C.O Sh.P.K., është apeluar në OShP me ekspertin shqyrtues që ka rekomanduar anulimin e vendimit të AK-së dhe rikthimin e lëndës në rivlerësim.

Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative

Komuna e Gjakovës në fund të vitit 2021, inicioi procedurën e mini-tenderimit për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, bazuar në kontratën kornizë të lidhur mes Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), dhe 16 operatorëve ekonomikë me titull “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative”, me numër të prokurimit UA/2016-19-9628-1-1-1.

Duke u bazuar në këtë kontratë kornizë të AQP-së, që kap vlerën 5,400,000.00 euro, autoritet kontraktuese do të ftonin operatorët ekonomikë që veçse ishin nënshkruar të kësaj kontrate në procedura të mini-tenderimit për furnizime me pajisje të IT-së. Në procedurën e mini-tenderimit të Komunës së Gjakovës, me numër prokurimi 632-21-10162-5-5-8, dhe në vlerë të parashikuar të kontratës 48,890.00 euro, morën pjesë tre operatorë ekonomikë. Me 08.04.2022, komuna publikoi njoftimin për dhënie të kontratës për grupin e OE-ve Tech Vision Sh.P.K.; Mehmet Sahitollu B.I.; Nita Macula B.I., si tenderi me çmimin më të ulët në vlerë prej 41,866.00 euro.

TABELA 7. Ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit publik

Nr.	Emrat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Grupi i OE Trio Tek Sh.P.K.; N.T.P Eramed: Artech	59,770.00 euro
2.	Grupi i OE Tech Vision Sh.P.K.; Mehmet Sahitollu B.I.; Nita Macula B.I	41,866.00 euro
3.	Aritech	44,300.00 euro

Fillimisht kontrata nuk ishte nënshkruar pas kërkesës për ri-shqyrtim të OE-së Aritech, që kishte çuar në pezullim të aktivitetit. Kjo kërkesë për ri-shqyrtim u refuzua si e pabazë dhe komuna vendosi që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Komuna e Gjakovës megjithatë nuk vazhdoi me nënshkrimin e kontratës, por shpalli njoftim për anulimin e dhënies së kontratës, me arsyetimin se OE fituese nuk kishte bërë vazhdimin e validitetit të ofertës, e cila sipas tyre fillimisht nuk ishte vërejtur nga autoriteti kontraktues, dhe në momentin që ishte vërejtur, ishte bërë anulimi i dhënies. Në këtë njoftim, AK po ashtu theksoi se do të vazhdonte me operatorin e dytë ekonomik, i cili kishte ofertë 2,434.00 euro më të shtrenjtë se grupi i OE Tech Vision Sh.P.K.; Mehmet Sahitollu B.I.; Nita Macula B.I. Në bazë të legjislacionit në fuqi, oferta duhet të këtë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës dhe se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.

RRUOPP⁷ përcakton se periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në Dosje të Tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës. Neni 31.4 i RRUOPP, përcakton se “Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)”.

Autoriteti kontraktues pretendon se përmes platformës elektronike e-prokurimi ka kërkuar nga OE-të pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit zgjatjen e validitetit të ofertës, ndërkohë operatori ekonomik, në ankesën e paraqitur në OShP, thotë se një kërkesë e tillë e AK-së nuk është dërguar asnjëherë në adresën e tyre. Komuna e Gjakovës është dashur të jetë e vëmendshme në përcjelljen e validitetit të ofertave, të bëjë kërkesën për zgjatje të validitetit para afat të skadimit dhe të verifikoj që të gjithë tenderët kanë pranuar këtë kërkesë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi vetë Komuna e Gjakovës në vendimin për ri-shqyrtim, pranon se nuk kanë vërejtur që nuk ishte bërë vazhdimi i validitetit të ofertës nga OE fituese, ndërkohë nuk është verifikuar nëse kërkesa për zgjatjen e validitetit të ofertave ishte pranuar nga tenderuesit.

Për shkak të gabimit të autoritetit kontraktues, ky aktivitet i prokurimit është anuluar në tërësi.



Komuna e Prishtinës

Zbatimi i platformës online për digjitalizim të shkollave (E-shkollori)

Komuna e Prishtinës në fund të dhjetorit të viti 2021 ka lidhur kontratë të negociuar me operatorin ekonomik (OE) Illyrian Sh.P.K. për zbatimin e platformës E-shkollori, platformë e cila është krijuar paraprakisht nga e njëjta kompani. Kjo platformë është lansuar në maj të vitit 2020 dhe ndihmon mësimin nga distanca, vlerësimin e nxënësve në mënyrë digjitale, mundëson komunikim online ndërmjet mësimeve dhe prindërve, si dhe ofron shumë shërbime tjera që kanë të bëjnë me raportin mësimdhënës-nxënës-prind.

Për këtë tender, autoriteti kontraktues (AK) ka ftuar për të ofertuar vetëm Illyrian Sh.P.K., e cila sipas Njoftimit për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik⁸ (KRPP) ka pronësi intelektuale, me ç'rast i është referuar dispozitës së nenit 35, paragrafi 2.1 të LPP-së, ku thuhet se “nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i jepet vetëm një operatori të caktuar ekonomik”. Edhe pse qëndron si arsyetim për të lidhur kontratë përmes negocimit, prapë ka pasur probleme tjera që janë evidentuar gjatë vlerësimit të ofertës dhe zbatimit të kontratës.

Vlera që komuna kishte paraparë për këtë aktivitet të prokurimit ishte 182,000.00 euro, derisa OE e ftuar dhe njëkohësisht fituese e kontratës ka ofertuar me 181,896.00 euro, çmim i cili është zbritur pas negociatave për 7,896.00 euro. Si përfundim, çmimi final i kontratës është nënshkruar për 174,000.00 euro apo 14,500.00 euro në muaj.

Për këtë shërbim, AK ka pasur edhe dy kontrata paraprake gjatë vitit 2020 dhe 2021, të cilat gjithashtu janë kontraktuar me Illyrian Sh.P.K. Kontrata e parë, e lidhur dy muaj pas fillimit të pandemisë, në maj të vitit 2020, e atë në kohëzgjatje prej pesë muajsh, është lidhur në shumë prej 41,300.00 euro, ku për një muaj komuna kishte paguar 8,260.00 euro, ndërkaq kontrata e dytë e marsit të vitit 2021, është lidhur për tetë muaj në vlerë prej 87,760.00 euro apo 10,970.00 euro në muaj. Siç mund të vërehet, çmimi i kontratës së fundit, e cila është akoma në fuqi është nënshkruar për pothuajse dyfishin e kontratave paraprake. Në këtë drejtim, tabela më poshtë liston çmimet që komuna ka kontraktuar të njëjtën kompani për të njëjtat shërbime për tri vite radhazi.

⁸ Njoftimi për KRPP-në është dërguar më 18.11.2021.

TABELA 8. Kontratrat mes Komunës së Prishtinës dhe Illyrian Sh.P.K. për platformën E-shkollori

Viti	Çmimi për një muaj	Vlera totale e kontratës	Kohëzgjatja e kontratës
2020	8,260.00 euro	41,300.00 euro	Pesë muaj
2021	10,970.00 euro	87,760.00 euro	Tetë muaj
2022	14,500.00 euro	174,000.00 euro	12 muaj

Sipas arsyetimit të dhënë në Raportin e Vlerësimit⁹, ky dallim dhe kjo rritje e çmimit ka ardhur si rezultat i trefishimit të kapaciteteve të “hostingut” dhe “bandwidth” (mirëmbajtjes dhe transmetimit të të dhënave), si dhe shtimit të 11 moduleve të reja, gjë që sipas tyre kjo ka reflektuar në rritjen e kostos.

Një prej dokumenteve që kërkohet të dorëzohet nga çdo operator ekonomik është deklarata nën betim, dokument i cili dëshmon përshtatshmërinë dhe pranueshmërinë e kandidatëve në aktivitetet përkatës të prokurimit. Deklaratat nën betim duhet të nënshkruhet nga persona kompetentë të OE-ve apo nga përfaqësuesit e autorizuar. Në rastin konkret, kjo deklaratë është nënshkruar nga një person që në ARBK nuk figuron as si pronare as si person i autorizuar, autorizim i cili nuk është bashkangjitur as në ofertën e dorëzuar te AK – Komuna e Prishtinës. Pavarësisht që LPP nuk e specifikon se nga kush duhet të nënshkruhet, sipas opinionit të dhënë nga KRPP, nënshkrimi “për” në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm¹⁰.

Nga ana tjetër, një prej kërkesave të Dosjes së Tenderit, nuk është bërë në përputhje me Ligjin për Prokurimit Publik. Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, komuna ka kërkuar nga operatori ekonomik të ofrojë dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata për shërbime të njëjta në tri vitet e fundit së bashku me një listë të kontratave, duke mos e saktësuar shumë që këto kontrata duhet ta mbërrijnë për t’u konsideruar si të pranueshme. Në bazë të kësaj kërkesë, OE Illyrian SH.P.K. ka ofruar vetëm dy referenca, një në vlerë prej 41,300.00 euro, e lëshuar nga Komuna e Prishtinës dhe referenca tjetër e lëshuar nga Komuna e Malishevës në vlerë prej 38,052.64 euro, por jo edhe listën e kontratave, të cilën komuna është dashur ta kërkojë përmes informatave sqaruese¹¹.

Në kuadër të analizimit të këtij tenderi, janë aranzhuar edhe dy takime me dy nga shkollat e Komunës së Prishtinës “Faik Konica”¹² dhe “Xhemail Mustafa”¹³. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë rëndësia dhe matja e përdorimit të platformës E-shkollori. Sipas drejtoreshave të këtyre dy shkollave, si platformë është mundësi shumë e mirë për të gjithë hisedarët, si për nxënës, mësimsdhënës, ashtu edhe për prindër, vetëm se ende nuk është krijuar praktika e përdorimit në 100% të saj. Si arsye për mospërdorimin e plotë të platformës është nevoja për të evidentuar gjithçka edhe në mënyrë fizike, obligim ky ligjor, gjë që sipas udhëheqësve të këtyre dy shkollave është dyfishim i punës së mësimsdhënësve, por që mundohen t’i kalojnë disa prej të dhënave edhe në platformë, vetëm se jo në kohë reale.

9 Raporti i Vlerësimit i datës 24.11.2021.

10 Opinioni nr.40 i KRPP-së <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=268>

11 Neni 72 i LPP-së “Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës”.

12 Takim me drejtoreshën e shkollës, Jehona Oruqi, datë: 03.02.2022.

13 Takim me drejtoreshën e shkollës, Shpresa Shala, datë: 03.02.2022.

Një prej problematikave të kësaj platforme është edhe mos-funksionimi i klasave virtuale, si njëra ndër komponentët më të rëndësishme të platformës. Sipas dy drejtoreshave të shkollave të lartcekura, E-shkollori, konkretisht klasa online biente shpesh në rastet kur përdorej për shkak të ngarkesës dhe zërimit të dobët, gjë që sipas tyre, i obligonte mësime të kalonin në platformën e hapur zoom.

Furnizimi i testeve të shpejta antigjen me pështymë

Komuna e Prishtinës në dhjetor të vitit 2021 inicioi procedurën e prokurimit (nr. të prokurimit 616-21-9891-1-1-5) për furnizim të shkollave me teste të shpejta antigjen përmes pështymës për COVID 19, duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Në këtë proces të prokurimit, Komuna e Prishtinës ftoi vetëm tre operatorë ekonomikë. Nga tri kompanitë e ftuara, vetëm dy ofertuan teksta kontrata u lidh me kompaninë e vetëm të përgjegjshme administrativisht, Madekos Sh.P.K., sipas kriterit të çmimit më të ulët. Kjo kompani oferto me çmimin 324,000.00 euro, duke tejkaluar vlerën e parashikuar për 4,000 euro.

TABELA 9. Ofertat e operatorëve ekonomikë që morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Operatorët ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1	Madekos Sh.P.K.	324,000.00 euro
2	N.Sh.T "Neramed"	450,000.00 euro

Pas negociimit me operatorin ekonomik Madekos Sh.P.K., Komuna e Prishtinës arriti ta zbriste çmimin nga 324,000.00 euro sa ishte oferta fillestare, në 316,000.00 euro, dhe lidhi kontratën me datën 16.12.2021.

Në këtë rast, Komuna e Prishtinës përdori procedurën e negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë, me arsyetimin se kishte një urgjencë për identifikimin e sëmundjeve virale potenciale tek nxënësit e shkollave të Prishtinës, teksa kjo formë e testimit për COVID 19 (me pështymë), përdorej për herë të parë në institucionet publike.

Komuna e Prishtinës nuk është dashur të përdorë procedurën e negociuar për shkak se pandemia e COVID 19, nuk ishte urgjencë në momentin e inicimit të kësaj procedure dhe se ky aktivitet i prokurimit ka mundur dhe është dashur të planifikohet më herët. Ndonëse është plotësuar kushti ligjor ku janë ftuar tre operatorë ekonomikë, negociimi me vetëm dy operatorë ka ndikuar që të reduktohet konkurrenca dhe rrjedhimisht të paguhet më shtrenjtë sesa çmimi në treg.

Në fillim të muajit dhjetor të vitit 2021, kohë gjatë të cilës është zhvilluar kjo procedurë e prokurimit, një test i tillë mund të kontraktohet për rreth dy (2) euro, ndërkohë nëse do të negociohej çmimi me shumicë pasi bëhej fjalë për 100 mijë teste, atëherë i njëjti do të mund të ulje deri në 1.6 euro për test. Për shkak të keqpërdorimit të procedurës së negociuar e cila ka çuar në ulje të konkurrencës, Komuna e Prishtinës ka mbi-paguar për furnizimin e këtyre testeve. Sipas Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik duhej të bënte trajnimin e stafit shkollor për përdorimin e këtyre testeve, gjë të cilën nuk e ka bërë

në bazë të takimeve që D+ ka pasur me shkollat përkatëse¹⁴, por vetëm ka dërguar në formë elektronike një video-manual të përdorimit.

Përveç mungesës së trajnimit për përdorimin e testeve, shkollat e Prishtinës po ashtu nuk janë furnizuar me pajisje mbrojtëse për administrimin e testeve, siç janë dorëzat dhe maskat mbrojtëse. Një problem tjetër i shfaqur me furnizimin e këtyre testeve antigjen me pështymë në shkollat e Prishtinës, ishte refuzimi i Qendrave të Mjekësisë Familjare¹⁵ (QMF) për të bërë testimin e nxënësve me simptoma, institucionet këto të cilat duke u thirrur në këtë furnizim, i referonin fëmijët përsëri në shkolla. Kështu, nxënësit me simptoma detyroheshin të shkonin në shkolla për t'u testuar, duke rrezikuar infektimin të mësimdhënësve dhe nxënësve të tjerë.

Sigurimi fizik i objekteve të komunës

Komuna e Prishtinës në shkurtit të vitit 2022 ka lidhur kontratë të negociuar në vlerë prej 126,748.80 euro për sigurimin fizik të objekteve të saja. Kjo kontratë në kohëzgjatje prej tre muajsh është nënshkruar me operatorin ekonomik Rojet e Nderit Sh.P.K., kompani e cila ka qenë në mesin e tri kompanive të ftuara. Pavarësisht që për të ofertuar kishin marrë ftesë tri kompani, vetëm kompania fitues Rojet e Nderit Sh.P.K., dhe kompania tjetër Alpha Private Security Sh.P.K. kishin arritur t'i dorëzojnë ofertat. Kjo e fundit ka ofertuar me 136,080.00 euro, përderisa vlera e parashikuar kishte qenë 157,500.00 euro.

Inicimin e këtij tenderi përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, AK e ka arsyetuar me ngecjen e lëndës në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)¹⁶, pas ankesave të dy operatorëve ekonomikë kundër vendimit për dhënie të kontratës për Rojet e Nderit Sh.P.K. Për shkak të mungesës së Bordit, OSHP nuk mori vendim për këto ankesa, por eksperti i caktuar shqyrtues ka nxjerrë një raport të ekspertizës lidhur me pretendimet ankimore. Eksperti në raportin e tij i kishte propozuar panelit shqyrtues që pretendimet e OE ankuese t'i aprovojë si pjesërisht të bazuara, ta anulojë njoftimin për dhënie të kontratës dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim¹⁷. Vlen të ceket që AK, nuk i kishte ftuar dy OE-të ankuese në tenderin e hapur përmes procedurës emergjente.

Komuna e Prishtinës gjatë vlerësimit të ofertave të tenderit që kishte vendosur ta iniciojë si emergjent, kishte anashkaluar disa kërkesë që i kishte vendosur në Dosjen e Tenderit, ajo për dorëzimin e listës së kontratave të realizuara dhe listën e automjeteve së bashku me dëshmitë përkatëse. Mosdorëzimi i dëshmimeve për dy kërkesat e lartcekura e bëjnë këtë operatorë të papërgjegjshëm dhe bazuar në dispozitat e LPP-së, oferta e të njëjtit është dashur të refuzohet. As oferta e Alpha Private Security nuk kishte qenë konform kërkesave të dosjes së tenderit, mirëpo ky OE ishte eliminuar vetëm për shkak të ofertimit me çmim më të shtrenjtë.

Disa shkelje procedurale janë bërë edhe sa i përket afatit të dorëzimit të ofertave. Dita e dorëzimit të ofertave është caktuar një ditë pas përgatitjes së Dosjes së Tenderit (DT). Më 19.01.2022 është përgatitur DT, ndërsa ditën e nesërme është dashur të dorëzohet oferta, pra më 20.01.2022, ndërkaq më 21.01.2022 janë hapur ofertat. Sipas LPP-së dhe RRUOPP-së, mundësia për shkurtimin e afateve është e paraparë për dy lloje të procedurave, për atë të hapur dhe të kufizuar, ndërkaq për procedurën e negociuar nuk është e precizuar.

¹⁴ Takimi i D+ me drejtoreshën e Sh.f.u "Faik Konica", Jehona Uruqi, i mbajtur me datën 3 shkurt 2022, dhe takimi me drejtoreshën e Sh.f.m.u "Xhemail Mustafa", Shpresa Shala, i mbajtur me datën 3 shkurt 2022.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Njoftim për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, 17.01.2022.

¹⁷ Raporti i ekspertit shqyrtues 230-267/21, 30.03.2021.

Pavarësisht që nuk është precizuar dhe është mangësi e ligjit, AK është dashur së paku t'i shfrytëzojë afatet e shkurtuara si për procedurën e kufizuar, duke qenë se për të ofertuar janë ftuar tre operatorë ekonomikë, gjë që një ditë nuk është e mjaftueshme për t'u siguruar që OE kanë pasur kohë të mjaftueshme për ta dorëzuar ofertën e tyre.

TABELA 10. Afatet e përshpejtuara sipas RRUOPP

	Procedurat	
	E hapur	E kufizuar
Me vlerë të madhe	15 ditë	15 ditë pranimi i kërkesës 10 ditë pranimi i tenderëve
Me vlerë të vogël	10 ditë	15 ditë pranimi i kërkesave 10 ditë pranimi i tenderëve

Fakti që Komuna e Prishtinës është thirrur në urgjencë nuk është dëshmuar në fazën e mëvonshme të kësaj procedure, pasi tek pas gati një muaji është nënshkruar kontrata, saktësisht më 18.02.2022. LPP i obligon AK-të që data e nënshkrimit të kontratës të jetë pas 10 ditësh nga publikimi i njoftimit për kontratë¹⁸. Kjo dispozitë i përjashton disa raste, ku hyjnë edhe urgjencat. Pra, në këtë rast pavarësisht që AK mund ta nënshkruajë menjëherë kontratën për shkak të urgjencës, komuna nuk e ka bërë një gjë të tillë, duke e shtyrë nënshkrimin e kontratës për një muaj.

Sipas kontratës, Rojet e Nderit Sh.P.K., do t'i mbulojnë 48 pozita, 29 që do të ruajnë 24h, një që do të ruajë 16 orë, dy që do të ruajnë 12 orë dhe 16 që do të ruajnë 8 orë në ditë. Mirëpo, askund nuk është e precizuar se cilat objekte të komunës do të ruhen dhe cilat janë ato pika ku do të qëndrojnë rojet e sigurisë.

Trajtimi i kafshëve endacake

Komuna e Prishtinës e ka hapur tender në janar të vitit 2022 lidhur me trajtimin e kafshëve endacake përmes zënies së qenve, kontrollimit, ushqimin, vaksinimin, kastrimin (sterilizimin) e tyre, lëshimin (kthimin) në vendin që janë marrë, kryerjen e procesit të eutanazisë dhe hospitalizimin prej 72 orësh. Ndryshe quhet metodë KSVL (kapje, sterilizim, vaksinim dhe lëshim) dhe konsiderohet si proces më human për uljen e numrit të qenve endacakë. Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë 50,000.00 euro, derisa vlera me të cilën është nënshkruar kontrata është 46,360.00 euro.

Qentë endacakë njihen si një prej problemeve më të mëdha të Komunës së Prishtinës, ku qytetarët e saj në përditshmërinë e tyre përballen me friken për të lëvizur të lirë në çdo orar të ditës. Adresimin e këtij shqetësimi për këtë vit, komuna e ka bërë përmes inicimit të këtij tenderi nën emërtimin "Trajtimi i kafshëve endacake", kontratë e cila është lidhur me negociim me të vetmin OE të ftuar, Veteria 1 Sh.P.K.

¹⁸ Neni 26.4.1. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese: Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale.

Oferta financiare e këtij OE, fillimisht kishte qenë 47,900.00 euro, vlerë e cila ishte ulur përmes negociatave, në 46,360.00 euro. Përdorimi i kësaj procedure ishte arsyetuar në Njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik¹⁹. Në këtë njoftim thuhet se arsyeja e shfrytëzimit të kësaj procedure është urgjenca për t'u trajtuar problematika e qenve endacakë, pasi shumë qytetarë kanë pësuar lëndime nga sulmet dhe kafshime e qenve.

Në njoftim përmendet tenderi paraprak që ishte hapur për të njëjtin qëllim, por me procedurë të hapur. Ky tender²⁰ kishte shkuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, pas ankesave të dy ofertuesve jo-fitues²¹. Andaj, sipas AK, shtimi i numrit të madh të qenve endacakë, kishte sjellë nevojën për ta lidhur kontratën e negociuar.

Në një prej kërkesave të Dosjes së Tenderit, komuna ka kërkuar që OE ofertues të dëshmojë që në tri vitet e fundit ka përfunduar kontrata për shërbime të njëjta, duke mos specifikuar shumën që duhet ta arrijnë këto kontrata. OE Veterina 1 ka dorëzuar një listë me katër kontrata dhe referencat përkatëse, dy nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUVK) dhe dy nga Komuna e Prishtinës. Mirëpo, kontrata që mund të kalkulohej si kontrata të përfunduara dhe të natyrës së njëjtë, janë vetëm njëra e AUVK "Shërbimet e menaxhimit dhe kontrollit të qenve endacakë – Regjioni i Prishtinës" – Lot 1 me nr. të prokurimit 40800-19-6574-2-1-5 me vlerë prej 20,000.00 euro, si dhe ajo me Komunën e Prishtinës, që ka të bëjë me tenderin "Trajnimi i qenve endacakë" me nr. të prokurimit 616-20-140-2-2-1 në vlerë prej 39,941.00 euro. Përderisa, dy kontratat tjera janë të natyrës jo të njëjtë që kanë të bëjnë me vaksinimin e gjedheve, deleve, dhive dhe qenve shtëpiakë dhe tenderi tjetër që ka të bëjë me "Shërbime veterinere në teren – Lot 1-Komuna e Prishtinës" me numër të prokurimit 40800-19-1186-2-1-5.

Pra, AK nuk ka cekur shumën që duhet ta arrijnë kontratat e përfunduara për punë të njëjtë, gjë që si kërkesë nuk është parashtruar sipas LPP-së. Pjesë e komisionit vlerësues të këtij tenderi, ku u rekomandua për kontratë Veterina 1 Sh.P.K., ishte Nexhmi Makolli, i cili është zyrtar përgjegjës i prokurimit në Komunën e Prishtinës. Pjesëmarrja e tij në komisionin vlerësues është e ndaluar me nenin 40.4 të RrOUPP, i cili thotë se zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk do të shërbej si anëtarë i komisionit vlerësues.

¹⁹ Datë: 10.01.2022.

²⁰ Trajtimi i qenve endacakë, nr. i prokurimit 616-21-1498-2-2-1

²¹ Ankesat kundër njoftimit për dhënie të kontratës për OE Veterina 1, janë parashtruar nga dy ofertues, nga GOE Crazy Pet Sh.P.K. & Blendit Bejdoni B.I. dhe OE Qendra për trajtimin e kafshëve Sh.P.K. Lidhur me pretendimet e oe anketues, eksperti shqyrtues kishte propozuar për panelin shqyrtues që ankesat e OE të aprovohen si pjesërisht të bazuara, që të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe që lënda të kthehet në rivlerësim. Për shkak të mos themelimit të bordit të OShP-së, ende nuk është marr asnjë vendim për këtë dhe shumë tenderë tjerë ndaj të cilëve është ushtruar ankesë, që nga marsi i vitit 2021.



Komuna e Prizrenit

Furnizim me material stomatologjik

Komuna e Prizrenit në qershor të viti 2022 inicioi procedurën e prokurimit për furnizim me material stomatologjik për nevojat e departamentit të stomatologjisë, në vlerë të parashikuar të kontratës prej 9,900.00 euro.

Në këtë procedurë të prokurimit morën pjesë dy operatorë ekonomikë, teksa fitues u zgjodh Matkos Pharm Sh.P.K, si operatori me tenderin me çmimin më të ulët, me të cilin u lidh kontrata me 10.08.2022. Nënshkrimi i kësaj kontrate paraqet fundin e sagës për furnizim me materiale stomatologjike mes Komunës së Prizrenit dhe Matkos Pharm Sh.P.K., që shtrihet në tri aktivitete të prokurimit.

TABELA 11. Ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit

Nr.	Operatorët ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1.	MATKOS PHARM Sh.P.K	7,496.50 euro
2.	PRO MEDICAL Sh.P.K	8, 346.00 euro

TENDERI I PARË: Komuna e Prizrenit në vitin 2021 kishte ndërprerë kontratën kornizë për furnizim me material stomatologjik (me nr. prokurimi 622-21-1045-1-2-1), të cilën e kishte lidhur me Matkos Pharm Sh.P.K., me pretendimin se ky OE kishte marrë pjesë në këtë procedurë të prokurimit me dokumente të falsifikuara.

Përveç shkëputjes së kontratës, Komuna e Prizrenit, me datën 08.07.2021, kishte bërë kërkesë në OShP për diskualifikimin e Matkos Pharm Sh.P.K., nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për një periudhë deri në një (1) vit, me arsyetimin se dy nga referencat e prezantuara në ofertë ishin konfirmuar nga institucionet përkatëse si të falsifikuara.

TENDERI I DYTË: vetëm dy ditë pas shkëputjes së kontratës nga ana e Komunës së Prizrenit, Matkos Pharm Sh.P.K., ofertoj përsëri në këtë institucion në ri-tenderimin e këtij aktiviteti të prokurimit (nr. 622-21-4365-1-2-1). Megjithëse ishte natyra e njëjtë me tenderin ku ishte përjashtuar, ky ishte aktiviteti i ri i prokurimit nga Komuna e Prizrenit dhe Matkos Pharm Sh.P.K., ofertoj përsëri. Këtë radhë ky operator ekonomik ndryshoi referencat duke mos i paraqitur ato të mëhershmet të cilat komuna pretendonte se ishin të falsifikuara.

Komuna e Prizrenit eliminoi Matkos Pharm Sh.P.K., edhe nga ky aktivitet i prokurimit, duke thënë se ky operator ekonomik ishte i papërgjegjshëm me kontratat e mëhershme të nënshkruara me këtë autoritet kontraktues. Duke qenë se ky operator ekonomik nuk ishte në Listën e Zezë të OShP-së (e cila kishte mbetur pa Bord dhe nuk e kishte shqyrtuar kërkesën e komunës), dhe për të nuk kishte një vendim përfundimtar të gjykatës (ndonjëse ishte arrestuar drejtori i kompanisë mbi dyshimin për falsifikim), eliminimin të cilin ja bëri Komuna e Prizrenit në këtë aktivitet ishte i jashtëligjshëm. Kjo pasi komuna shkeli nenin 65 të LPP-së, i cili thotë se nuk mund të ketë diskualifikim të ndonjë ofertuesi jashtë kërkesave të përshtatshme të përcaktuara në LPP.

Në lidhje me këtë situatë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), me kërkesë të Demokraci Plus (D+) ka dhënë një interpretim²², duke konsideruar se autoriteti kontraktues, në këtë rast Komuna e Prizrenit, nuk mund të deklarojë të papërshtatshëm një OE-në, të cilën vetë e ka paraqitur në OShP, në një procedurë të re të prokurimit. Ndonjëse oferta e eliminuar e Matkos Pharm Sh.P.K., ishte më e lira, Komuna e Prizrenit shpërbleu me kontratë ofertuesin e dytë N.T.Sh Koslabor. Ky vendim për shpërblimin ofertuesit të dytë u apelua nga Matkos Pharm Sh.P.K., me aktivitetin e prokurimit që mbeti i bllokuar për një vit, derisa Komuna e Prizrenit vendosi të anuloi në tërësi këtë proces me datën 10.08.2022.

Kjo histori mes Komunës së Prizrenit dhe Matkos Pharm Sh.P.K., shpërfaq pasojat që krijoi mos-emërimi i anëtarëve të rinj të bordit të OShP-së nga Kuvendi i Kosovës, duke bërë që ky organ ndër tjerash të dështoi në zbatimin e LPP-së, konkretisht nenit 99, i cili e obligon që në rastet kur ka kërkesa nga autoritetet kontraktuese në lidhje me paraqitjen e dokumenteve të falsifikuara nga operatorët ekonomikë, të bëjë shqyrtimin dhe diskualifikimin e këtyre operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Në lidhje me referencat e dyshuara si të falsifikuara, Prokuroria Themelore në Prishtinë me 30.12.2021 ngriti aktakuzë²³ kundër drejtorit të Matkos Pharm Sh.P.K., me pretendimin se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurimin publik” nga neni 415 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Vetëdijesimi i nxënësve të shkollave fillore dhe vozitëse në Komunën e Prizrenit për sjellje në trafik

Komuna e Prizrenit në prill të vitit 2022 filloi procedurën e tenderimit për vetëdijesimin e nxënësve të shkollave fillore dhe vozitës për sjellje në trafik. Për këtë aktivitet të prokurimit që kishte vlerë të parashikuar të kontratës 40,000.00 euro, ofertuan tre operatorë ekonomikë.

22 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Pyetjet e Shpeshta. Nr. 93. 14.10.2022. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Cla-nakitemNew.aspx?id=268> (qasur për herë të fundit me 16.10.2022).

23 Prokuroria Themelore në Prishtinë ka konfirmuar përmes e-mailit zyrtar për D+ se me datë 31.12.2021, ka ngritur aktakuzë kundër personit me inicialet L.B., në drejtim të veprës penale “Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”, nga neni 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe të njëjtën e ka proceduar në gjykatën kompetente për trajtim të mëtejshëm.

TABELA 12. Ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit

Nr.	Operatorët ekonomikë	Vlera totale e ofertës
1.	Ballon Pacha – Project Sh.P.K	24,580.00 euro
2.	Grupi i OE Limit L&B Sh.P.K.; Model 5 doo & Sfinga Sh.P.K	20,508.47 euro
3.	Samire Osmani B.I	39,950.00 euro

Komisioni vlerësues rekomandoi për lidhje të kontratës, kompaninë Samire Osmani B.I, me emrin tregtar Eko Pastrimi DDD, si operatori ekonomik me çmimin më të lirë, pasi dy ofertuesit e tjerë u shpallën të papërgjegjshëm administrativisht, përkundër që kishin çmimin më të lirë në krahasim me operatorin fitues

Ky tender kishte për qëllim vetëdijësimin e nxënësve dhe vozitësve për sjellje në trafik, por fitues u shpall një kompani që aktivitetet primare e ka pastrimin e përgjithshëm të ndërtesave, shërbimin dhe mirëmbajtjen e shesheve, larjen kimike të tekstitit etj²⁴. Në Dosjen e Tenderit, përkatësisht te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, Komuna e Prizrenit kërkoi që operatorët ekonomikë të jenë të pajisura me certifikatat ISO 9001: 2015, ISO 14001: 2015 dhe ISO 45001:2018.

ISO 9001: 2015 është standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për menaxhim të cilësisë, i cili shërben për të demonstruar aftësinë që kanë kompanitë për të ofruar në vazhdimësi produkte dhe shërbime²⁵. ISO 14001: 2015 është standard vullnetar që certifikon organizata që ndjekin një kornizë të menaxhimit të ambientit²⁶. Ndërkohë, ISO 45001:2018, specifikon kërkesa dhe jep udhëzime që iu mundësojnë organizatave të ofrojnë ambiente të sigurta dhe të shëndetshme të punës, duke parandaluar lëndimet dhe sëmundjet e lidhura me punën²⁷.

Edhe në vitin 2021, Komuna e Prizrenit kishte hapur tender për vetëdijësimin e nxënësve në shkolla fillore dhe vozitës për sjellje në trafik, në vlerë të parashikuar 40,000.00 euro. Ndonëse qëllimi i dy aktiviteteve të prokurimit i paraparë në Dosjet e Tenderit dhe shërbimet e kërkuara në paramasa janë të njëjta, në vitin 2021 nuk ishte kërkuar asnjë ISO certifikatë. Këto certifikata nuk lidhen me natyrën e tenderit pasi nuk kanë të bëjnë me fushata të vetëdijësimit dhe vendosja e tyre në Dosjen e Tenderit, ngriti dyshimin se favorizojnë një operator ekonomik.

Nga tre operatorët ekonomikë që ofertuan, vetëm Samire Osmani B.I prezantoi ISO certifikatat e kërkuara, të cilat figurojnë se janë lëshuar vetëm tri ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave.

Në përshkrimin e certifikatave të prezantuara, shkruan se janë të vlefshme për fushat e aplikimit:

“Shërbime të DDD-së (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), largimit të zvarranikëve; të mbrojtjes së mjedisit si dhe Fushata vetëdijësimi. Tregim i produkteve dezinfektuese dhe biocideve”.

24 Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,155269> (qasur për herë të fundit me 11.11.2022).

25 What is ISO 9001:2015 – Quality Management Systems. <https://asq.org/quality-resources/iso-9001> (qasur për herë të fundit me 11.11.2022).

26 What is ISO 14001:2015 – Environmental Management Systems? <https://asq.org/quality-resources/iso-14001> (qasur për herë të fundit me 11.11.2022).

27 ISO 45001:2018 Occupational health and safety management systems – Requirements with guidance for use. <https://www.iso.org/standard/63787.html> (qasur për herë të fundit me 11.11.2022).

Edhe në tenderin e vitit 2021, që kishte numër të prokurimit 622-21-1780-2-2-1, me kontratë ishte shpërblyer kompania Samire Osmani B.I, që ishte në kosorcium me B&D Business Support Center L.L.C.

Në të dy aktivitetet e prokurimit për vetëdijesimin e nxënësve në komunikacion, kompania me të cilën është lidhur kontrata ka qenë kompania e vetme e përgjegjshme administrativisht që ka ofertuar, dhe në dy rastet, çmimi i kontraktuar ishte mbi 95% e vlerës së parashikuar, që ngrit dyshimin tjetër që ky operator ekonomik mund të ketë qenë në dijeni paraprakisht për kërkesat e tenderit.

TABELA 13. Vlera e kontratave të nënshkruar në dy aktivitetet e prokurimit për vetëdijesimin e nxënësve të shkollave fillore për sjellje në komunikacion

Viti kur është nënshkruar kontrata	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës së nënshkruar	Përqindja e çmimit të kontraktuar krahasuar me vlerën e parashikuar
2021	40,000.00 euro	38,200.00 euro	95.5%
2022	40,000.00 euro	39,950.00 euro	99.87%
2022	14,500.00 euro	174,000.00 euro	12 muaj

Furnizimi me inventar për zyrë dhe ordianca shëndetësore

Komuna e Prizrenit në maj të vitit 2022 hapi aktivitetin e prokurimit për furnizim me inventar për zyrë dhe ordianca shëndetësore me numër të prokurimit 622-22-5067-1-2-1. Në këtë tender që kishte qëllim furnizimin me karrige, tavolina, dollapë nga druri me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 euro, komuna përdori procedurën e hapur ku morën pjesë katër (4) operatorë ekonomikë.

TABELA 14. Ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit

Nr.	Operatorët ekonomikë	Çmimi i peshuar i ofertave
1.	Mobelland Sh.P.K	748.10 euro
2.	Wood Corporation L.L.C	2,582.85 euro
3.	Gent Ademaj	2,910.97 euro
4.	Trendy Home	2,116.10 euro

Pas vlerësimit të ofertave, komuna rekomandoi për kontratë kompaninë Mobelland Sh.P.K., me çmimin e peshuar prej 748.10, si ofertuesi me çmimin më të lirë. Ky vlerësim i Komunës së Prizrenit nuk ishte në harmoni me LPP-në, konkretisht me nenin 61 i cili thotë se në rast se një operator ekonomik dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues duhet të dërgojë një kërkesë me shkrimi për shpjegime në lidhje me bazën e tenderit.

Tenderi i dorëzuar nga Mobelland Sh.P.K., është tender me çmim jo normalisht të ulët i cili plotëson tri kriteret e formulës ligjore të përcaktuara me rregulloren B57 të KRPP-së. Në këtë situatë, autoriteti kontraktues nuk ka mundur të bëjë refuzimin e ofertës, por është dashur të kërkojë sqarime inter partes me qëllim që të zërthejë elementet e tenderit që kanë çuar në çmimin e ofertuar.

TABELA 15. Kushtet që duhen plotësuar që një tender të konsiderohet se ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta

Kushtet që duhen plotësuar që oferta të cilësohet si jo normalisht e ulët	Situata
Të jenë dorëzuar të paktën tri (3) oferta;	Janë pranuar katër oferta
Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;	Çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm është 2,086.01 euro. Çmimi i Mobelland Sh.P.K është 64.14% më i ulët.
Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët	Çmimi i ofruar është 65.65% më i ulët se çmimi i dytë më i ulët.

Komuna e Prizrenit nuk kërkoj shpjegime shtesë nga operatori ekonomik fitues, ndonëse për këtë pati kërkesë për ri-shqyrtim nga ana e operatorit të dytë me çmimin më të ulët, Trendy Home Sh.P.K., me pretendimin se bëhej fjalë për çmime jo normalisht të ulëta. Po ashtu, komuna refuzoi këtë pretendim të Trendy Home Sh.P.K., me anë të një vendimi²⁸ në të cilin thuhet se pretendimet se operatori ekonomik fitues ka çmime jo normalisht të ulëta nuk qëndrojnë dhe se çmimet e ofertuar për inventar nga ky operator janë aktuale në treg.

Kjo lëndë është dërguar në OShP, ku paneli shqyrtues ka aprovuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik Trendy Home Sh.P.K., duke bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës për Mobelland Sh.P.K dhe rikthimin e lëndës në rivlerësim. Në këtë rast, autoriteti kontraktues nuk ka bërë saktë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave duke mos vërejtur se bëhet fjalë për çmime jo normalisht të ulëta, që pastaj ka ndikuar që ky aktivitet të apelohej në OShP me furnizimin që nuk ka filluar kur kanë kaluar më shumë se pesë muaj²⁹ që nga mbyllja e afatit për dorëzimin e ofertave.

Organizimi i festivalit të këngës së vjetër Zambaku i Prizrenit 2022

Komuna e Prizrenit në maj të vitit 2022, hapi tenderin me numër të prokurimit 622-22-3939-2-2-1 për organizimin e festivalit tradicional të këngës së vjetër “Zambaku i Prizrenit”, me qëllim që të sigurohet pjesa teknike e mbajtjes së këtij festivali. Vlera e parashikuar e tenderit ishte 30,000.00 euro, ndërkohë

28 Vendimi i Komunës së Prizrenit sipas kërkesës për ri-shqyrtimi të datës 08.08.2022, të parashtruar nga operatori ekonomik Trendy Home Sh.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar për zyrë dhe ordianca shëndetësore me Nr. të Prokurimit: 622-22-5067-121”.

29 Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë me datën 21.06.2022 deri në ora 14:00. Hapja e tenderit është bërë me datën e njëjtë.

si afat i fundit për dorëzimin e ofertave u caktua data 25 maji, duke qenë se ky festival planifikohej të mbahej në fund të muajit qershor.

Në këtë aktivitet të prokurimit morën pjesë tre operatorë ekonomikë, ku fitues u shpall grupi i operatorëve ekonomikë N.Sh Shkolla Private e Muzikës Studio Heflix; TV Prizreni (tutje GOE fitues), si tenderi me çmimin më të ulët në vlerë prej 23,956.00 euro.

TABELA 16. Ofertat e operatorëve ekonomikë që morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	Amc Corporation Sh.P.K.,	27,615.00 euro
2.	Sfinga Sh.P.K.,	25,600.00 euro
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.Sh. Shkolla Private e Muzikës Studio Helix; TV Prizreni	23,956.00 euro

Ndonëse konkurruan me çmimin më të ulët, oferta e grupit ekonomik i cili u rekomandua për kontratë kishte mangësi të mëdha, të cilat e bënin ofertues të papërgjegjshëm që duhej eliminuar që në fazën fillestare të vlerësimit. Në bazë të analizimit të ofertës së GEO fitues, vërehet se mungonte Deklarata nën Betim, e cila duhet të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset në origjinal. Kjo dëshmi kërkohet të jetë pjesë e dokumentacionit në momentin kur dorëzohet oferta dhe shërben si parakusht për të vazhduar me procesin e kualifikimit.

GEO fitues po ashtu nuk kishte plotësuar as kriterin mbi mundësitë teknike, ku parashihej që operatori ekonomik duhej të kishte realizuar projekte të natyrës së kontratës në tri vitet e fundit në vlerë minimale jo më pak se 45,000.00 euro. Në ofertën e GEO fitues, referencat e projekteve të realizuara të natyrës së kontratës arrijnë vlerën totale 32,158.72 euro, vlerë kjo e cila nuk plotëson pragun minimal të nenit 9.1 të Dosjes së Tenderit. Në Dosje të Tenderit po ashtu është kërkuar që operatori ekonomik të këtë së paku pesë (5) të punësuar me profile të ndryshme, adekuate për realizimin e kontratës të cilët duhen dëshmuar përmes listës së të punësuarve në ATK në tre muajt e fundit. Në bazë të dhënave në ATK, kompania Studio Helix ka katër (4) të punësuar ndërkohë anëtarit tjetër tjetër i konsorciumit, TV Prizreni nuk ka ofruar të dhëna për asnjë të punësuar.

Operatori ekonomik i dytë me çmimin më të lirë, Sfinga Sh.P.K., ngriti kërkesën për ri-shqyrtim kundër njoftimit për dhënien e kontratës për GEO fitues, me pretendimin se konsorciumi të cilit iu dha kontrata nuk plotësonte kriteret e specifikuar në Dosje të Tenderit. Komuna e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë, duke lënë në fuqi vendimin për dhënien e kontratës, pa dhënë arsyetime për pretendimet ankimore.

Përveç se vlerësimi i ofertave nuk u bë në përputhje me nenin 59 të LPP-së, i cili thotë se gjatë vlerësimit duhet të merren parasysh kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontrata, Komuna e Prizrenit shkeli nenin 108 të LPP-së³⁰ duke mos arsyetuar refuzimin e kërkesës për ri shqyrtim.

30 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Neni 108, pika 10. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në

Edhe kjo lëndë u dërgua në OShP, ku paneli shqyrtues aprovoi si të bazuar ankesën e OE Sfinga Sh.P.K., duke anuluar vendimin³¹ e Komunës së Prizrenit dhe duke kthyer lëndën në ri-vlerësimi.

Komuna e Prizrenit fillimisht nuk bëri vlerësimin e saktë të ofertave sipas kritereve të cilat i kishte vendosur në Dosjen e Tenderit, e pastaj gaboi në ri-shqyrtimin e ankesës duke mos arsyetuar vendimin e saj. Për shkak të këtyre gabimeve, edicioni i 33-të i festivalit “Zambaku i Prizrenit”, që ishte planifikuar të mbahej në fillim të muajit qershor, u shty deri në nëntor.

lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

31 Vendimi nr.277/22 i panelit shqyrtues të OShP. <https://bit.ly/3WldlO9>



Komuna e Gjiçanit

Pastrimi i objekteve shkollore

Komuna e Gjiçanit ka iniciuar procedurën e fundit për pastrimin e objekteve shkollore në prill të vitit 2022, me vlerë të parashikuar prej 40,334.00 euro. Ky aktivitet është zhvilluar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, ndërsa është lidhur me grupin e operatorëve ekonomikë (GOE) Krasniqi Sh.P.K. dhe N.T.P. Beni me datë 13.04.2022, në vlerë prej 40,262.86 euro, me kohëzgjatje prej një muaji. Kontratë për të njëjtin qëllim është lidhur edhe më vonë në vitin 2022, e cila është lidhur me GOE e njëjtë, në vlerë prej 87,050.00 euro, e cila po ashtu është zhvilluar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Në vitin 2021, Komuna e Gjiçanit ka zhvilluar dy procedura për të njëjtin qëllim, por të cilat i ka zhvilluar me procedurë të hapur e që këto procedura kanë përfunduar të anuluar nga ana e komunës.

Sipas LPP-së, procedura e negociuar mund të përdoret nëse për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet të lidhet me një OE të caktuar, nëse duhet të mbrohen të drejtat e pronës intelektuale apo industriale apo të drejta ekskluzive, nëse ekzistojnë rrethana të emergjencave ekstreme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen³². Më konkretisht, nëse kemi të bëjmë me një kontratë të shërbimeve, atëherë kjo kontratë duhet të zhvillohet me procedura të negociuara nëse kontrata pason një konkurs projektimi dhe nëse OE gëzon të drejtë ekskluzive për të siguruar atë shërbim³³. Në rastin e kësaj kontrate, përdorimi i kësaj procedure nuk del të ketë pasur bazë ligjore. Kjo sepse fillimisht nuk ka ndodhë ndonjë e papritur e cila nuk ka mundur të parashikohet nga komuna, për më tepër sipas dokumentit të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve³⁴, shohim se komuna ka potencuar se ky aktivitet i prokurimit ka qenë i paraparë me planin vjetor të prokurimit. Kjo kontratë nuk ka qenë kontratë pasuese e ndonjë konkursi paraprak projektimi dhe gjithashtu OE i kontraktuar nuk gëzon të drejta ekskluzive për kryerjen e këtij furnizimi. Kjo do të thotë se komuna nuk ka pasur të drejtë të përdorë këtë procedurë, e cila ka përjashtuar nga aplikimi OE tjerë që ofrojnë këtë shërbim, në këtë mënyrë duke kufizuar konkurrencën. Megjithatë, komuna në procedurë të negociuar ka ftuar tre operatorë ekonomikë që të paraqesin ofertat e tyre.

Për të përdorur këtë procedurë, institucioni duhet të njoftoj KRPP-në në afatin prej dy ditësh nga data e vendimit për përdorimin e kësaj procedure dhe të arsyetoj përdorimin e kësaj procedure. Sipas ko-

32 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 35, pika 2.

33 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 35, pika 2.3.

34 Dokument i marrë pas kërkesës për qasje në dokumente publik, e dërguar me 26.08.2022.

munës, për shkak të skadimit të kontratës paraprake mes OE dhe komunës për pastrim të objekteve, është dashur që iniciohet një procedurë e tillë në mënyrë që të mos ketë shpëputje të ofrimit të këtij shërbimi. Shpjegimi për KRPP-në ngjanë me dokumentin e njësisë së kërkesës për të iniciuar këtë procedurë, ku ndër të tjera në shpjegim thuhet "...kërkojmë nga zyra e prokurimit që të bëhet ndonjë zgjidhje e mundshme dhe afatgjate me qëllimin më të mirë që të mos kemi ngecje për këto shërbime. Andaj, urgjentisht kërkojmë nga zyra e prokurimit që në suaza të Ligjit të Prokurimit, të zhvilloi aktivitetin e prokurimit me procedurën e negociuar. Afati kohor për realizimin e kësaj kontrate do të jetë 1 muaj dhe vlera e parashikuar e kësaj kontrate është 40,334.00". Në këtë shpjegim është kërkesa e njësisë së kërkesës, ku në të njëjtën kërkohet të bëhet një zgjidhje afatgjate e në anën tjetër thuhet që kjo kontratë të lidhet për periudhën prej një muaji. Çfarëdo qoftë nevoja e komunës, në asnjë situatë nuk ofrohet zgjidhje përmes kontraktiveve një mujore. Madje, kërkesa që ky aktivitet të iniciohet me procedurë të negociuar pa publikim të kontratës nuk është dashur të pranohet për faktin se një zhvillim i këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë i paraparë dhe rrjedhimisht i planifikuar të prokurimit.

Komuna e Gjilanit ka iniciuar disa procedura të cilat kanë pasur për qëllim kontraktimin e një kompanie e cila do të bëjë pastrimin e objekteve shkollore. Për këto dy vite, 2021 dhe 2022 për të njëjtën procedurë janë iniciuar katër procedura, dy nga to janë anuluar ndërsa dy të tjera janë kontraktuar. Dy nga procedurat e anuluar janë zhvilluar me procedurë të hapur, ndërsa ato të kontraktuarat janë zhvilluar me procedurë të negociuar pa publikim të kontratës. Fakti se vetëm aktivitetet e zhvilluara me procedurë të negociuar kanë rezultuar me lidhje të kontratës është interesant ngase tregon se komuna nuk ka arritur me sukses të lidhë kontratat me procedurë të hapur, për më tepër të njëjtat janë anuluar nga ana e vet komunës. Arsyet e anulimit në njërin rast kanë ardhur si shkak i pamundësisë të korigjimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ngase anulimi nuk është mundësuar nga platforma elektronike e-prokurimi, ndërsa tjetri si rezultat i një shkelje ligjore i cili nuk ka mundur të rregullohet.

Në rastin e parë të anulimit të tenderit, komuna është thirrur në nenin 62, pika 2.2 të LPP-së, që thotë se lejohet anulimi nëse vjen si shkas i një ngjarje objektive dhe që mund të demonstron, të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues. Në po të njëjtën pikë thuhet se kjo duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve³⁵. Hapja e tenderëve është planifikuar të bëhet me datë 05.01.2021, ndërsa një njoftim i tillë është lëshuar me datë 27.01.2022, apo 22 ditë më vonë se data e planifikuar për hapje të ofertave. Po ashtu, arsyet që kanë dërguar deri te pamundësitë e cekura janë për shkak të vonësve që kanë ndodhur si rezultat i kërkesave për rishqyrtim. Mirëpo, kërkesat për rishqyrtim nuk mund të konsiderohen shkaqe të cilat nuk mund të parashikohen për shkak se thajse në çdo aktivitet të prokurimit ka kërkesa për rishqyrtim. Prandaj, komuna nuk do të duhej të thirrej në një ngjarje të tillë që të bëhet anulimi i kësaj procedure të rëndësishme ngase nuk qëndron si arsye, për më tepër vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë 1,343,997.00 ku me një veprim të tillë këto mjete janë bllokuar deri në aktivitetin e radhës.

Në rastin e dytë të anuluar, komuna është thirrur në nenin 62, pika 1.1 e LPP-së, e cila lejon të anulohet aktiviteti nëse ka ndodhur një shkelje e ligjit aktual apo mendohet se do të ndodhë një shkelje, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit³⁶. Në njoftimin për anulim, komuna ka treguar se ka pasur një kërkesë për rishqyrtim ku edhe e ka pezulluar aktivitetin dhe është bërë korigjimi i dosjes së tenderit, mirëpo në asnjë pjesë të këtij njoftimi nuk ka treguar se cila është ajo shkelje ligjore që ka ndodhur apo që do të ndodhë. Ky vendim nuk tregon asnjë shkelje prandaj edhe nuk është treguar të ketë pasur ndonjë bazë ligjore që të bëhet anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit.

35 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 62, pika 2.2.

36 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 62, pika 1.1.

Në këtë mënyrë, kjo ka krijuar situatën që në zhvillimin e radhës të të njëjtit aktivitet, komuna të përdorë procedurë të negociuar pavarësisht se nuk ka bazë ligjore për përdorim të kësaj procedure, ngase nuk plotësohen asnjëra nga kërkesat ligjore. Anulimi i procedurave të prokurimit, veçanërisht në raste të tilla dëmton në tërësi planifikimin e prokurimeve të komunës dhe paranë publike.

Siç është theksuar edhe më lartë, kontrata mes palëve kontraktuese është lidhur me vlerën prej 40,262.86 euro me kohëzgjatje prej një muaji. Për të shpenzuar këtë shumë të parasë publike, komuna nuk ka kërkuar nga GOE i shpërblyer me kontratë që të dëshmojë për gjenden ekonomike e financiare dhe për mundësitë teknike e profesionale. Në dosje të tenderit, komuna për operatorin ofertues ka kërkuar që të dorëzoj vetëm dëshminë për regjistrim si operator ekonomik, numrin fiskal të operatorit, certifikatën e biznesit dhe regjistrimin e TVSh-së, pra ka paraqitur vetëm kërkesat e përshtatshmërisë profesionale dhe ato të pranueshmërisë që janë deklarata nën betim, vërtetimin nga gjykata dhe nga ATK.

Këto kërkesa janë të pamjaftueshme dhe nuk vërtetojnë se operatori fitues ka kapacitete për kryerjen e këtyre punëve, madje edhe tregon mungesën e përgjegjësisë së komunës për shpenzimin e parasë publike. Për një tender me vlerë të mesme do të duhej që komuna të sigurohej se operatori ka kryer punë të tilla më herët, se ka punëtorë të mjaftueshëm dhe mjete të mjaftueshme për kryerjen e këtij shërbimi, po ashtu të sigurohej se ka të bëjë me një biznes stabil i cili ka qarkullim të mjaftueshëm financiar.

Për të marrë pjesë në këtë tender janë ftuar tre operatorë ekonomikë, ku dy operatorët tjerë janë eliminuar me arsyetimin se oferta e tyre nuk ka qenë me çmimin më të ulët. Fillimisht, GOE fitues kishte ofertuar në vlerë prej 40,312.86 euro, ndërsa pas negociatave është ulur oferta financiare në 40,262.86 euro, apo 50 euro më e ulët.

TABELA 17. Operatorët ekonomikë ofertues dhe vlera e ofertave të tyre

Nr.	Operatori ekonomik ofertues	Vlera e ofertës
1	Erik Sh.P.K.	40,470.10 euro
2	Schafberger Jr. GmbH	40,519.65 euro
3	GOE Krasniqi Sh.P.K. & N.T.P.Beni	40,262.86 euro

Në paramasën e këtij tenderi janë paraparë tri pjesë, pjesa e parë ka të bëjë me sipërfaqet për pastrim, pjesa e dytë me materialin për pastrim dhe pjesa e tretë me kompensimin për stafin ndihmës teknik. Në grupin e parë janë paraqitur gjashtë shkolla që do të pastrohen, mirëpo në dy pozicionet e fundit (1.7 dhe 1.8) janë paraqitur kërkesat për gjashtë punëtorë, të cilët do të angazhohen si kujdestarë të dyert e shkollave (pra, për secilën shkollë nga një kujdestar).

Me këtë tender janë paraparë që të pastrohen gjashtë shkolla, ku metri katror për pastrim të sipërfaqeve të brendshme do të paguhet me 0.55 euro, sipërfaqet e jashtme 0.03 euro, ndërsa salla e edukatës fizike 0.40 euro. Për pastrimin e këtyre sipërfaqeve, komuna ka kërkuar nga GOE që të ofrojë listën me minimum 24 punëtorë dhe paga neto minimale për ata punëtorë duhet të jetë 251.70 euro, e të cilët do të punojnë pesë ditë në javë dhe t'i pastrojnë objektet dy herë në ditë.

TABELA 18. Pozicionet 1.7 dhe 1.8 të paramasës

	Emri i objektit për pastrim	Njësia	Sasia Totale	Çmimi për njësi	Muajt për pastrim	Shuma për një muaj	
1.7	Përkujdesja dhe mirëmbajtja e dyerve të hyrjes të shkollës Mehmet Isai dhe Arbëria gjatë tërë ditës	Kujdestaria te dyert – hapja dhe mbyllja e tyre	Cope	4	338.10	1	1,352.40
1.8	Përkujdesja dhe mirëmbajtja e dyerve të hyrjes të shkollës Marin Barleti gjatë tërë ditës	Kujdestaria te dyert hapja dhe mbyllja e tyre	Cope	2	338.10	1	14,538.60

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Siç edhe shihet në tabelën 18, OE ka plotësuar paramasën e cila tregon se këta punëtorë do të paguhet 338.10 euro. Mirëpo, komuna në total ka kërkuar nga OE që të parasheh pagesën për 100 punëtorët, ku përveç punëtorëve të kompanisë duhet të përfshihen edhe 75 punëtorët të cilët aktualisht punojnë në këto shkolla. Komuna nuk do të duhej të linte në përgjegjësi të OE-së fituese të paguaj punëtorët të cilën realisht nuk janë punëtorët të kompanisë por janë të komunës. Punëtorët të cilët janë nën mbulimin financiar të komunës, duhet t'ju krijohet zgjidhje nga komuna dhe të njëjtit të mos varen nga kompanitë që operojnë në këtë fushë.

TABELA 19. Pjesa e tretë e paramasës, ku është përfshirë pagesa për 75 punëtorët të cilët punojnë në shkolla.

Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi mujore neto	Muajt për kompensim	Shuma
A		b	c	d	e	f=c*d*e
	Punëtorët teknik nëpër objektet shkollore dhe stafi tjetër ndihmës si pastrues etj.	Persona	75€	€ 338.10	1	€ 25,357.50
Gjithsej						€ 25,357.50

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Gjithsesi, komuna e Gjilanit ka krijuar një zgjidhje, gjithashtu të përkohshme, për mirëmbajtësit e shkollave publike të kësaj komune duke lidhur marrëveshje me ndërmarrjen publike Tregu Sh.A., ku procedurat e tilla nuk do të kalojnë më përmes prokurimit.

Në këtë situatë të komplikuar, parregullësia më e madhe qëndron në faktin se OE ka vendosur në parmasë kompensimet monetare për punëtorët në neto. Pra, komuna nuk ka qenë e kujdesshme në këtë element të rëndësishëm ku mos pagesa e tatimit në pagë por edhe për kontribute pensionale është injoruar plotësisht. OE nuk ka paraparë kompensimin monetar bruto për punëtorët, e as komuna nuk ka planifikuar pagesën e këtyre tatimeve dhe nuk ka ndonjë mekanizëm për një kompenzim të tillë. Një veprim si ky është shumë i dëmshëm në shumë aspekte, fillimisht bëhet evizion fiskal duke mos paguar tatimet duke rënë në kundërshtim me të gjitha aktet ligjore të vendit, shkakton dëmtime në të hyra publike por edhe dëmton punëtorët ngase të njëjtit i pamundësohet pagesa e kontributeve pensionale për të cilat secili qytetar ka nevojë në një moshë të caktuar.

Trajtimi i qenve endacak

Komuna e Gjilanit ka kontraktuar operatorin ekonomik Monumi Sh.P.K., për të bërë trajtimin e qenve endacak. Ky operator ekonomik ishte i vetmi që kishte aplikuar për të marrë pjesë në këtë tender, me ofertën në vlerë prej 18,500.00 euro me të cilën vlerë edhe u nënshkrua kontrata në kohëzgjatje prej 12 muajsh. Me këtë tender është planifikuar që të trajtohen 250 qenë dhe puna ka filluar më 22.06.2022. Ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar me plan të prokurimit, pavarësisht faktit se problem me qenët endacak është evident në tërë vendin. Meqenëse ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar, komuna nuk duhet të përdorë dispozita ligjore që i dedikohen emergjencave në prokurim, pasi që një problematikë e tillë nuk është e re a e as ngjarje e paparashikuar.

Për këtë tender është shkurtuar afati për dorëzim të tenderëve, mirëpo nuk është dhënë sqarime në dosje të tenderit se pse është marrë ky veprim. Gjithsesi, autoriteti kontraktues në çdo rast duhet të caktoj një afat të mjaftueshëm kohor, për t'i dhënë operatorit ekonomik mundësi për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet e nevojshme të kërkuara në dosje të tenderit. Shkurtimi i afateve kohore pa ndonjë arsye e cila e bënë të pamundur respektimin e afateve kohore të parapara me LPP, fillimisht paraqet shkelje të LPP-së por edhe kufizon konkurrencën. Kjo për shkak se operatorët e interesuar nuk kanë kohë të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar, veçanërisht nëse kemi të bëjmë me një tender me kompleksitet më të lartë dhe nëse në dosje të tenderit janë kërkuar dëshmi të shumta që duhet të dorëzohen për tu konsideruar i përgjegjshëm. LPP dhe RrUOPP kanë paraparë afatet kohore dhe mundësitë e shkurtimit të këtyre afateve, prandaj AK nuk lejohet të përcaktojë afate kohore të cilat janë më të shkurtra se ato të përcaktuara me dispozita ligjore në LPP dhe RrUOPP.

Ky tender ka vlerë të mesme, andaj afati kohor normal për kontrata me vlerë të mesme të cilat zhvillohen me procedurë të hapur duhet të jetë 20 ditë³⁷. Ndërsa, nëse kemi të bëjmë me afate kohore të shkurtuara, atëherë për kontrata të vlerës së mesme që zhvillohen me procedurë të hapur, afati duhet të jetë 10 ditë³⁸. Afatet kohore kalkuloohen duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Data e publikimit të njoftimit për kontratë për këtë tender ka qenë data 19.05.2022, ndërsa afati për dorëzim të tenderëve është caktuar të jetë 30.05.2022, që i bje se OE të interesuara për të ofertuar në këtë tender kishin vetëm 11 ditë kohë për të përgatitur dokumentacionin për të dëshmuar se plotëso-

37 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, pika 21.

38 Po aty.

jnë kërkesat e paraqitura në dosje të tenderit. Kjo do të thotë se komuna ka respektuar afatin kohor të shkurtuar, mirëpo problemi qëndron në çështjen nëse shkurtimi i afatit kohor ka bazë ligjore. LPP, në nenin 46 ka paraparë rregullat e posaçme për shkurtimin e afateve kohore, ku janë paraparë disa rrethana ku lejohet shkurtimi i afateve kohore. Këto rrethana janë kur duhet të zbatohet një aktivitet i prokurimit në raste urgjente, kur bëhet e pamundur respektimi i afateve kohore të përcaktuara me nenin 44 dhe 45 të LPP-së, nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1 i LPP-së dhe nuk mund tu atribuohen veprimeve ose mos-veprimeve të autoritetit kontraktues³⁹.

Shkurtimi i afateve kohore dhe përshpejtimi i dorëzimit të tenderëve për një tender të kësaj natyre nuk do të duhej të aplikoheshin, ngase nuk ka bazë ligjore për këtë to. Komuna e Gjilanit do të duhej ta planifikonte këtë aktivitet të prokurimit dhe ta zhvillonte më herët me afate kohore të rregullta. Prandaj, edhe siç thuhet në nenin 46 të LPP-së, shkurtimi i afateve nuk mund tu atribuohen mos-veprimeve të autoritetit⁴⁰. Fakti që një veprim i tillë ka dëmtuar konkurrencën, dëshmohet me atë se në këtë procedurë të prokurimit, pavarësisht se është zhvilluar me procedurë të hapur, ka ofertuar vetëm një operator ekonomik. Pra, para se të vendosen afatet kohore, AK duhet të ketë parasysh ndërlikueshmërinë e tenderit, ku në këtë rast përveç se është shkurtuar afati për dorëzim të ofertave, AK ka paraqitur një sërë kërkesash që operatori duhet t'i plotësoj në mënyrë që të konsiderohet si i përgjegjshëm e rrjedhimisht të mund të shpërblehet me kontratë.

Komuna e Gjilanit ka kërkuar që OE të dorëzoj një deklaratë nën betim për kërkesat e përshtatshmërisë, një deklaratë nën betim me të cilën deklaron se OE posedon një qendër të grumbullimit të përkohshëm të qenve, certifikatat e biznesit, vërtetimet nga gjykata dhe ATK, një listë së bashku me referenca të kontratave të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit, dy veterinarë të diplomuar për të cilët kërkohet të bashkëngjiten kopje të diplomës, licenca, CV, kontrata e punës ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt dhe punët e mëparshme. Po ashtu, komuna ka kërkuar që operatori të ketë dy teknik të veterinarisë dhe për të njëjtit të bashkëngjit të njëjtin dokumentacion sikurse për dy veterinarët. Gjithashtu, është kërkuar që përmes librezave të qarkullimit, dokumentit unik doganor apo ndonjë marrëveshje për shfrytëzim, të dëshmohet se OE ka në posedim dy automjete "pick up" dhe një eskavator.

Në ofertën e OE janë dorëzuar një mori dokumentesh. Fillimisht, për të dëshmuar se ka kryer punë të ngjashme, OE ka dorëzuar një listë të gjatë të kontratave të realizuara. Mirëpo, komuna nuk ka bërë asnjë kërkesë për shumën që duhet të arrijnë këto kontrata. Në tri vitet e fundit, OE ka realizuar 33 kontrata ku ato kontrata kryesisht kanë qenë për kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit (DDD) në institucione të ndryshme dhe furnizim me ushqim, ndërsa për shërbime të tilla si kjo e kontratës, janë realizuar vetëm katër kontrata. Madje, tri kontratat e fundit të listuara janë në realizim e sipër e të cilat nuk do të duhej të vendoseshin në këtë listë sepse janë kontrata të papërfunduara. Këto kontrata është kërkuar që të shoqërohen me referenca, ku janë dorëzuar vetëm dy referenca të lëshuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për dy kontrata. Njëra kontratë e këtij operatori me AUV ka përfunduar më 26.04.2021, ndërsa tjetra ka përfunduar më 01.10.2022. Kjo nënkupton se në kohën kur OE ka aplikuar dhe shpërblyer me kontratë, ka qenë duke ekzekutuar një kontratë mjaft të madhe në vlerë prej 46,000.00 euro. Kur një OE merr për sipër që të ekzekutoj më shumë se një kontratë publike në të njëjtën kohë, e vë në dyshim shërbimin dhe kualitetin që do të ofrojë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me kontrata të mëdha siç janë këto të dyja. Në kontratën me AUV, kërkesa ka qenë që të trajtohen deri në 10,000 krerë kafshë të ndryshme shtëpiake, ndërsa me këtë tender do të trajtohen 250 krerë qenë, që nënkupton se nevojitet staf ndërsa OE ka dëshmuar se ka vetëm tetë veterinarë.

39 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 46, pika 1.

40 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 46, pika 1, iii.

Komuna e Gjilanit me të njëjtin OE, përveç kësaj kontrate ka edhe dy kontrata të tjera aktive që janë në realizim e sipër. Njëra kontratë ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të DDD-së në vlerë prej 101,690.00 euro ndërsa kontrata tjetër ka për qëllim furnizimin me ushqim të kafshëve në vlerë prej 83,256.00 euro. Kontrata e parë është nënshkruar më 14.07.2022, me të cilën janë kërkuar që OE të ketë një veterinar dhe katër teknikë të veterinarisë, ndërsa tenderi i dytë është nënshkruar me datë 14.06.2022, pra pak ditë para nënshkrimit të kësaj marrëveshje, me të cilin janë kërkuar që të dëshmojë për një veterinar dhe një teknik të veterinarisë. Pra, vërehet se e njëjta kompani ka marrë përsipër të përfundojë shumë punë, prandaj menaxheri i kontratës duhet të jetë i kujdesshëm në raportim për këtë kontratë kjo pasi që është thuajse e pamundur që të përfundohen kaq shumë shërbime në kohë të njëjtë.

Kontratën e njëjtë, Komuna e Gjilanit e kishte lidhur me të njëjtin OE në vitin 2019. Mirëpo, në tenderin e vitin 2019 për trajtimin e qenve endacak, AK kishte sqaruar në paramasë shërbimet që kërkoheshin të kryheshin dhe çmimin për atë pozicion.

TABELA 20. Paramasa e tenderit për trajtim të qenve në vitin 2019 e lidhur në mes të Komunës së Gjilanit dhe OE Monuni Sh.P.K..

Nr.	Përshkrimi	Çmimi njësi me TVSh
I.	Zënia dhe transportim i qenve endacak deri në klinikën veterinare	45.00
II.	Trajtimi kundër parazitëve	20.00
III.	Kastrimi ose sterilizimi i tyre dhe vendosja e metrikulave	10.00
IV.	Trajtimi me eutanazi në raste të veçanta	1.00

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Komuna e Gjilanit ka specifikuar shërbimet që do të kryhen në katër pozicionet, për të cilat edhe është caktuar çmimi për njësi. Mirëpo, në këtë paramasë nuk është vendosur numri i saktë se sa qenë kërkohet që të trajtohen prandaj edhe është vendosur çmimi më i lartë te pozicioni i parë, pra te zënia dhe transportimi i qenve. Megjithatë, vendosja e çmimeve të tilla bie në kundërshtim me legjisllacionin për kompensimin financiar për shërbimet veterinare në terren, i cili tregon qartë se cilat duhet të jenë tarifat për këto shërbime. Sipas tij, për zënie/kapjen e qenve endacak dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore për krerë/copë, kompensimi duhet të jetë 15.00 euro, për trajtimin (kontrollin, ushqimin, vaksinimin, dehelmentizimin, identifikimin) e qenve endacak kompensimi për krerë/copë duhet të jetë 10.00 euro, për kastrim apo sterilizim 35.00 euro, ndërsa për eutanazi 25.00 euro⁴¹. Ngjashëm ka ndodhur edhe me paramasën e këtij tenderi, ku në paramasë nuk janë vendosur fare pozicionet e as çmimi për njësi, por vetëm totali dhe numri i qenve që do të trajtohen.

⁴¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2018 për Kompensimin Financiar për Shërbimet Veterinare në Teren, shtojca 1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37699>

TABELA 21. Paramasa e tenderit për trajtim të qenve në vitin 2022 e lidhur në mes të Komunës së Gjilanit dhe OE Monuni Sh.P.K.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Shuma në €
1.	Trajtimi i qenve endacak	Copë	250	18,500.00
Totali:				18,500.00

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Një paramasë e tillë është plotësisht gabim ngase nuk mund të lihet në diskrecion të OE të vendosë për nevojat e autoritetit, ngase trajtimi i qenve endacak mund të përfshijë shumë por edhe pak, pra vetëm ndonjë zënie dhe trajtim. Për më tepër, një paramasë e tillë krijon konfuzion për faktin se nuk dihet a bëhet fjalë për trajtimin që ka të bëjë me kontrollin, ushqimin, vaksinimin, dehelmentizimin dhe identifikimin apo me trajtimin që nga fillimi deri në lëshim apo eutanazim. Kërkesat lidhur me trajtimin janë vendosur në dosje të tenderit, mirëpo të njëjtat do të duhej të vendoseshin edhe në paramasë në mënyrë që të përcaktohet saktë çmimi për secilin pozicion. Një saktësim i tillë eliminon mundësinë për keqpërdorime ngase operatori mund të vendosë çmim të lartë në zënie e qenve, sikurse në rastin para-prak ku për 250 qenë nga 45.00 euro, atëherë i bije se 11,250.00 euro të tenderit të shpenzohen vetëm në zënie, ndërsa me 7,250.00 të kryej trajnimin, kastrimin, hospitalizimin e eutanazinë. Elemente të tilla sado që duken teknike, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit të implementimit, por edhe në realizimin e qëllimit të kontratës. Kështu që në çdo situatë tjetër komuna duhet të kujdeset që të vendosë saktësisht pozicionet në paramasë dhe t'i përmbahet legjislacioni në fuqi.

Përveç gabimeve nga ana e komunës, edhe operatori në disa raste ka dështuar të plotësojë kërkesën e komunës. Komuna ka kërkuar nga OE që të ofrojë dëshmi se posedon staf profesional prej dy veterinerëve dhe dy teknikëve të veterinarisë. Për të dëshmuar këtë kërkesë është dashur të dorëzohen diplomat universitare, licencat, CV-të, kontrata e punës me punëdhënësin apo marrëveshja për angazhim në këtë projekt dhe referenca në punët e mëhershme. OE ka dorëzuar dokumente për tetë veterinerë ku asnjëra nga diplomat nuk ka qenë e noterizuar, për asnjërin nga veterinarët nuk është dorëzuar licenca për ushtrimin e profesionit të mjekut të veterinarisë, për disa nga këta veterinarë është dorëzuar kontrata e punës me datë të skaduar, e disa nga këta veterinerë kontratat e punës i kanë të lidhura për pozitat si menaxher apo sektorist në një barnatore veterinarë e bujqësore, e në disa CV të këtyre veterinarëve as nuk përmendet se janë ose kanë qenë të punësuar te ky operator.

Këto mangësi lënë mundësinë për të kërkuar informata shtesë nga komuna, mirëpo nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmbushë kërkesat bazike, atëherë ka bazë që tenderi të refuzohet pa kërkuar informacione shtesë⁴². Gjithashtu, është kërkuar një eskavator për të cilin duhet të dorëzohet librezë apo DUD dhe nëse ky mjet merret nga ndonjë marrëveshje të dorëzohet e njëjta. Mirëpo, OE në ofertën e tij ka dorëzuar vetëm një marrëveshje që thotë se një OE tjetër do të bëjë hapjen e gropave dhe nuk është dorëzuar asnjë dokument për eskavatorin në fjalë. Kjo nënkupton se marrëveshje është lidhur jo për marrjen në shfrytëzim të mjetit, por në formë të nën kontraktimit të operatorit tjetër për kryerjen e punëve në hapjen e gropave. Kjo shkon përtej kërkesave të dosjes së tenderit, dhe e njëjta nuk do të duhej të pranohej. Komuna përveç që ka bërë shkurtimin e afatit për dorëzim të tenderëve, ka bërë

⁴² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, pika 39.8.

përpilim të gabuar që hap mundësinë për keqpërdorim dhe gjithashtu ka shpërblyer me kontratë një kompani e cila nuk ka plotësuar me saktësi kërkesat e autoritetit.

Dezinsektimi hapësinor, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve në komunën e Gjilanit - ritender

Komuna e Gjilanit me datë 06.06.2022 publikoi njoftimin për kontratën për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim të objekteve të komunës së Gjilanit. Ky aktivitet ka qenë në procedurë të ritenderimit sepse paraprakisht tenderi me numër të prokurimit 651-22-1970-2-1-1 është anuluar me arsyetimin se si rezultat i kërkesave për rishqyrtim, komuna nuk e ka të mundur të bëjë korrigjimin e dosjes së tenderit ngase kërkesa e fundit për rishqyrtim është dorëzuar me datë 26.05.2022 ndërsa me datë 30.05.2022 do të bëhej hapja e ofertave. Pra, komuna është arsyetuar në faktin se kur të arrihet koha për hapje të ofertave, nuk mund të korrigjojnë më dosjen e tenderit. Mirëpo, sipas nenit 62, pika 2.2 e LPP-së i cili thotë se lejohet anulimi nëse vjen si shkas i një ngjarje objektive dhe që mund të demonstron, të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues, një veprim i tillë duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve⁴³. Pavarësisht se neni në të cilin komuna është thirrur për anulim, kërkon që një vendim i tillë të merret së paku tre ditë para hapjes së ofertave, komuna këtë veprim e ka ndërmarrë pikërisht në ditën e njëjtë kur edhe është planifikuar hapja e ofertave për këtë tender.

Vendimi për anulim është publikuar në orën 16:04, që i bje se është publikuar në fund të orarit të punës dhe në një situatë e tillë mund të lindin dyshimet se ofertat mund të jenë hapur. Prandaj, autoriteti kontraktues duhet që kurdo që aplikon këtë nen për anulim të aktivitetit të prokurimit, të njëjtin ta zbaton në tërësi. Po ashtu, edhe për këtë aktivitet të prokurimit është shkurtuar afati për dorëzim të ofertave. Komuna në arsyetimin e dhënë për shkurtim të afatit për dorëzim të ofertave ka theksuar se ky aktivitet është i nevojshëm dhe duhet të ri-tenderohet sepse është e domosdoshme të bëhet dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve në komunën e Gjilanit si dhe nga njësia kërkuuese u është kërkuar që të vazhdohet me ri-tenderim në afat sa më të shkurtër. Pra, sipas kësaj, njësia e kërkesës ka kërkuar që të shkurtrohet afati dhe të vazhdohet sa më shpejtë me këtë procedurë.

Për tu shkurtuar afati duhet të plotësohen kushtet e parapara me ligj. Për një kontratë publike të tillë me vlerë të madhe, afati nuk duhet të jetë më pak se 15 ditë⁴⁴. Për këtë kontratë njoftimi është publikuar më 06.06.2022 ndërsa afati për dorëzimin të ofertave është përcaktuar të jetë deri më 24.06.2022, që i bje se operatorët e interesuar për të aplikuar për këtë tenderë kanë pasur 18 ditë kohë për të përgatitur dokumentacionet e nevojshme. Pavarësisht se nuk është shkelur kjo normë ligjore, pikëpyetja qëndron nëse komuna ka pasur të drejtë të bëjë shkurtimin e afateve për dorëzim të ofertave.

LPP ka paraparë disa situata të cilat nëse ekzistojnë, AK ka të drejtë të shkurtoj afatin. Sipas LPP-së shkurtimi i afateve lejohet kur duhet të zbatohet një aktivitet i prokurimit në raste urgjente, kur bëhet e pamundur respektimi i afateve kohore të përcaktuara me nenin 44 dhe 45 të LPP-së, nëse kemi të bëjmë me të drejtën e pronës intelektuale apo industriale, kur kemi të bëjmë me situatat kur detyrohet t'i jepet kontrata një operatori ekonomik të caktuar për arsye teknike ose artistike dhe në rastet të emergjencave ekstreme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen⁴⁵. Komuna e Gjilanit në dosje

⁴³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 62, pika 2.2.

⁴⁴ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, pika 21.

⁴⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 46, pika 1.

të tenderit ka sqaruar se ky aktivitet i prokurimit ka qëllim që të parandalojë sëmundjet ngjitëse dhe eliminimin e baktereve e mikroorganizmave të dëmshëm për shëndetin e popullatës, dhe sqarohet se komuna ka për qëllim që ky aktivitet të jetë i rregullt për çdo vit në mënyrë që të krijohen kushte për një jetesë më të shëndetshme për qytetarët. Po ashtu, dokumenti “Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” tregon se një aktivitet i tillë është planifikuar. Nga kjo mund të përfundojmë se komuna nuk ka pasur të drejtë të bëjë shkurtrimin e afateve për dorëzim të ofertave pavarësisht se ky tender ka qenë në ri-tenderim. Për më tepër, kur procedura pas anulimit ritenderohet, nënkupton se fillohet me një procedurë krejtësisht e re por pa i ndryshuar emërtimin e prokurimit. Kjo nënkupton se për këtë procedurë do të duhej të lihej koha e nevojshme për përgatitje sikurse të ishte tenderi i parë.

Asfaltimi i rrugës në lagjen Arbëria

Komuna e Gjilanit ka iniciuar disa procedura të cilat kanë pasur për qëllim asfaltime në pjesë të ndryshme të qytetit. Një nga ato ka qenë edhe procedura për asfaltimin e rrugës në lagjen Arbëria, e cila është zhvilluar me procedurë të hapur, për të cilën ishin ndarë 198,127.00 euro që i bije të ketë qenë procedurë me vlerë të mesme. Për këtë kontratë kanë ofertuar shtatë operatorë ekonomikë, mirëpo kontrata është lidhur me GOE Bejta Commerce Sh.A. & Murseli Sh.P.K. në vlerë prej 165,480.25 euro. Punimet për asfaltimin e kësaj rruge janë planifikuar të kryhen brenda tre muajve aq sa edhe zgjatë kontrata.

TABELA 22. Operatorët ekonomikë ofertues në këtë tender dhe vlera e ofertave të tyre

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertës
1	Company Zuka Commerc Sh.P.K.	177,108.99 euro
2	GOE Bejta Commerce Sh.A. & Murseli Sh.P.K.	165,480.25 euro
3	K.N.P.Sh. Papenburg & Adrian Company Sh.P.K.	165,996.08 euro
4	Tali Sh.P.K.	203,354.54 euro
5	El – Bau Sh.P.K.	197,934.54 euro
6	Pro & Co Group Sh.P.K.	189,095.18 euro
7	GOE SBP Construction Sh.P.K.	173,550.49 euro

Për këtë tender janë kërkuar të plotësohen një sërë kërkesash, të cilat sipas autoritetit kontraktues janë përmbushur nga grupi i operatorëve që janë shpallur fitues. Në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, ka një numër mjaft të madh të kërkesave që duhet të plotësohen në mënyrë që OE të jetë i përgjegjshëm dhe të shpallet fitues. Këto kërkesa janë plotësuar nga GOE i shpallur fitues mirëpo të gjitha kërkesat janë plotësuar nga lideri i grupit, i cili ishte përcaktuar të jetë OE Bejta Commerce Sh.A., ndërsa OE tjetër anëtar kishte kontribuar në këtë bashkim vetëm me paraqitjen e dy mjeteve të domosdoshme për kryerjen e punëve.

Pavarësisht asaj se LPP nuk parasheh ndonjë ndarje të përgjegjësisë ndërmjet operatorëve që formojnë një grup, RrUOPP lejon mundësinë që autoriteti kontraktues të caktojë në dosje të tenderit përmbushje e caktuar të njërit operator dhe të tjetrit. Sipas LPP-së, të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe

veçmas përgjegjës para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit, ata janë gjithashtu së bashku dhe veçmas përgjegjës para autoritetit kontraktues për ekzekutimin e kontratës në fjalë⁴⁶. Kjo do të thotë se qëllimi i krijimit të grupit të operatorëve ekonomikë është të mbështesin njëri tjetrin me burime financiare, punëtorë dhe kapital, në mënyrë që të shpërblehen me kontratë por edhe që të realizojnë në mënyrën më të mirë atë kontratë. Në një rast si ky, qëllimi i krijimit të grupit nuk është arritur ngase qarkullimi financiar, lista e kontratave të realizuara, stafi profesional dhe një pjesën më të madhe të kërkesës për mjete, stabilimente dhe pajisje teknike, janë plotësuar vetëm nga njëri anëtar i grupit.

LPP por as RrUOPP nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të veçantë me të cilën përcaktohet se sa përqind (%) e projektit duhet të realizohet nga lideri dhe sa nga anëtari tjetër i grupit. Megjithatë, RrUOPP i jep të drejtën autoriteteve kontraktuese që të vendosin një kërkesë për përmbushje të detyrave. Sipas RrUOPP-së, atëherë kur është e nevojshme, AK-të mund të përcaktojnë në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomikë mund të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësitë teknike dhe profesionale⁴⁷. Kjo nënkupton se AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimi të kërkesave nga njëri anëtar i grupit të operatorëve ekonomikë.

AK duhet të përdorë këtë mundësi që i ka ofruar ligji dhe të sigurohet se operatorët ekonomikë bashkohen në grupe me qëllim të kryerjes së punëve sipas nevojave të komunës. Nëse vetëm njëri nga anëtarët e grupit ka plotësuar kërkesën për qarkullim bankar, kontrata të realizuara, pajisje e punëtorë, nënkupton se vetëm ky OE do të kryej punët e këtij tenderi ngase realizimi i kontratës do të arrihet përmes atyre mjeteve dhe atyre punëtorëve që janë paraqitur me ofertë. E nëse ky OE ka kapacitete ekonomike, financiare, teknike e profesionale që i vetëm të përmbush kontratën atëherë vihet në pikëpyetje qëllimi i krijimi të grupit.

Në raste të tilla ekziston mundësia që të krijohet grupi i operatorëve me të vetmin qëllim që kur të lëshohet referenca për kontratën e realizuar, të njëjtën të mund ta përdorë edhe anëtari i cili nuk ka kontribuar në punë si mundësi për të fituar tenderë të tjerë në të ardhmen. Kjo, nga ana e AK-ve nuk duhet lejuar të ndodhë sepse ekziston mundësia që në të ardhmen të shpërblehet me kontratë një operator që ofron referencë të tillë e që mund të ndikoj në mos realizimin e mirë të projektit. Nëse autoriteti kontraktues zgjedhë të mos aplikoj përqindje (%) në përmbushje të kërkesave në dosje të tenderit, atëherë duhet që kurdo që autoriteti kontraktues lëshon referencë të përcaktoj saktësisht dhe qartësisht në fletë referencë përqindjet (%) e punëve që kanë kryer secili anëtar i grupit.

Për këtë çështje, edhe KRPP ka lëshuar një interpretim i cili thotë se referencat e lëshuara në emër të grupit mund të pranohen nga AK në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit. Operatori ekonomik mund t'i drejtohet AK-së që e ka lëshuar referencën që të caktoj përqindjen e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit. Përqindjen e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit, AK është i obliguar ta përcaktoj në referencë⁴⁸.

46 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 71, pika 3.

47 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, pika 27.4.

48 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Pjetjet e shpeshata, 26.



Komuna e Pejës

Ndriçimi dhe kubëzimi i hapësirave publike në komunën e Pejës - pjesa II

Komuna e Pejës në vitin 2021 ka inicuar procedurën për rregullimin e disa shesheve dhe ndriçimin publik në disa fshatra të kësaj komune. Mirëpo, kjo procedurë është anuluar në gusht të vitit 2021 dhe e cila u finalizua tek në mars të vitit 2022. Kjo procedurë është ndarë në katër lloje, të cilët përfshijnë fshatrat si Gorazhdevc, Lozhan, Loxhe, Poqest e Vragoc, gjithashtu përfshihen edhe hapësirat publike rreth QKMF-së dhe lagjja e Gjimnazit. Për këto katër lloje, operatorët ekonomikë të interesuar mund të ofertojnë për të gjitha pjesët mirëpo mund të fitojnë vetëm një lot. Në rast se ofertuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se një lot, atëherë ai do të shpërblehet me lotin i cili është më i favorshëm për autoritetin kontraktues.

Vlera e përgjithshme e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është 466,647.50 euro, me kohëzgjatje prej 3 muajsh. Për lot 1 nga kjo shumë janë ndarë 72,848.00 euro, për lot 2 janë ndarë 96,998.00 euro (40,000.00 euro nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL), për lot 3 janë ndarë 101,913.00 euro (40,000.00 euro nga MAPL) dhe 194,888.50 euro janë ndarë për lot 4 (60,771.78 euro nga MAPL).

LOT1 – Rregullimi i sheshit në f.sh. Gorazhdevc dhe ndriçimi publik në fshatrat Lozhan, Loxhë, Poqest dhe Vragoc - pjesa 1

Komuna e Pejës më 02.08.2021, rreth një muaji pasi publikoi njoftimin për dhënie të kontratës, anuloi Lot 1 të këtij aktiviteti të prokurimit. Në njoftimin për anulim, komuna ka theksuar se ky aktivitet është anuluar sipas një urdhri të lëshuar nga OShP i cili kërkon anulimin e dhënies së kontratës dhe i cili është në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të LPP-së. Mirëpo, sipas nenit përkatës, autoriteti kontraktues pasi ka pranuar kërkesën për rishikim, ta miratojë si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar⁴⁹. Pra, ky nen flet vetëm për kompetencën e AK-së për anulim të një vendimi, ndërsa në njoftimin për anulim, komuna ka arsyetuar se OShP ka marrë vendim dhe ka urdhëruar një anulim të tillë, që nënkupton se baza ligjore e paraqitur në njoftimin për anulim nuk lidhet me vendim të OShP-së. Kompetencën e OShP-së në një situatë të tillë e rregullon pika 14 e nenit 108/A, e cila lejon që kundër refuzimeve të miratuara nga AK, pala e interesuar mund të paraqes ankesë në OShP. Për më tepër, një procedurë e tillë nuk mund të gjendet në platformën elektronike të ankesave të OShP-së, që i bje se nuk është marrë vendim nga OShP për këtë procedurë.

⁴⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 108/A, pika 10.2.

Në po të njëjtin dokument te seksioni i informacioneve shtesë, komuna thekson se arsyeja e anulimit të këtij njoftimi për dhënie është se OE ka bërë disa gabime në paramasë ku vlera e gabimit tejkalon mbi 2%. Këto janë gabime aritmetike në tender të cilat nëse shuma e korigjuar është më pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla. Ndërsa, nëse shuma që duhet korigjuar kalon më shumë se +/- 2%, atëherë AK do të eliminoj operatorin ekonomik⁵⁰. Në këtë rast, komuna e Pejës është dashur që pas hapjes së ofertave dhe vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues të shpallte grupin si të papërgjegjshëm dhe të njëjtin ta eliminonte nga gara. Pra, nuk do të duhej që ta shpallte atë si fitues dhe më vonë të anulonte Lotin në tërësi.

TABELA 23. Ofertat e operatorëve ekonomikë për Lot 1

Nr.	Operatorët ekonomikë	Çmimi i ofertave
1	GOE BK-Construction Sh.P.K. & Ilir Lajçi B.I.	70,484.00
2	GOE Engineering Group Sh.P.K. & Ridvan Elezi B.I.	84,135.00
3	BM Group Sh.P.K.	87,131.00
4	Sky Line Co Sh.P.K.	73,046.50
5	Mondi Sh.P.K.	69,707.00
6	GOE N.P.Sh El-Ing & Asfalti Sh.P.K.	53,034.00

Siç vërehet edhe nga tabela, oferta më e lirë ka qenë nga GOE N.P.Sh El-Ing & Asfalti Sh.P.K., mirëpo i njëjti është shpallur si i papërgjegjshëm ngase sipas njoftimit për vendim të AK-së, ky GOE ka paraqitur në ofertën e tyre vetëm dy inxhinierë ndërsa me dosjen e tenderit janë kërkuar tre të tillë.

Sikurse në këtë situatë ku komisioni vlerësues ka gjetur se GOE me ofertën më të lirë nuk mund të shpërblehet me kontratë për shkak se është i papërgjegjshëm, njësoj do të duhej të vepronte edhe me GOE që ishte shpallur fitues. Gjithsesi, komuna nuk do të kishte mundësi tjetër përveç se ta anulonte këtë Lot për shkak se për të ishin ndarë 72,848.00 euro, ndërsa ofertat e tjera tejkalojnë vlerën e parashikuar. Prandaj, komuna në këtë situatë do të duhej të mbështetej në nenin 44 të RrUOPP-së i cili lejon anulimin e tenderëve pas hapjes së ofertave nëse të gjitha ofertat e operatorëve të përgjegjshëm tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues⁵¹ dhe të mos shpallte fitues asnjë nga operatorët përkatës.

Për këtë lot është zhvilluar një procedurë e re, ritender me numër të prokurimit 635-21-5160-5-2-1. Vlera e parashikuar për këtë tender ishte e njëjtë, pra 72,848.00 euro, me kohëzgjatje prej 3 muajsh. Me kërkesat e njëjta në dosje të tenderit, për këtë Lot është shpërblyer me kontratë GOE N.P.Sh. El-Ing & Asfalti Sh.P.K., me ofertën në vlerë prej 67,997.00 euro.

50 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, neni 41, pika 8.

51 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, neni 44, pika 6.

TABELA 24. Paramasa e parë me çmimet e vendosura nga GOE N.P.Sh. El-Ing & Asfalti Sh.P.K.

Lot 1 – REKAPITULIMI		
1	Rregullimi I Hapësirës Publike Në Fshatin Gorazhdevc	26,175.00
2	Rregullimi i Hapësirës Publike në fshatin Llozhan dhe Muret Rrethuese të Varrezave në Fshatin Vragoc dhe Poqest	7,718.00
3	Ndërtimi I Ndriçimit Publik Në Fshatrat Poqest, Babiq, Millovanc Dhe Vragoc	19,141.00
GJITHSEJ 1+2+3		53,034.00

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

TABELA 25. Paramasa e dytë me çmimet e vendosura nga GOE N.P.Sh. El-Ing & Asfalti Sh.P.K.

Lot 1 – REKAPITULIMI		
1	Rregullimi i hapësirës publike në fshatin Gorazhdevc	26,175.00
2	Rregullimi i hapësirës publike në fshatin Llozhan dhe muret rrethuese në Fshatin Vragoc dhe Poqest	22,396.00
3	Ndërtimi i ndriçimit publik në fshatrat: Poqest, Babiq, Millovanc dhe Vragoc	19,426.00
GJITHSEJ 1+2+3		67,997.00

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Pavarësisht se punët që do të kryhen janë plotësisht të njëjta, në kategorinë e dytë shohim një dallim shumë të lartë ndërmjet çmimeve që janë vendosur në paramasën e parë dhe asaj të dytë. Për rregullimin e hapësirave publike në fshatin Llozhan dhe mureve rrethuese të varrezave në fshatin Vragoc dhe Poqest, në ofertën e parë është paraparë që të shpenzohen 7,718.00 euro, ndërsa në të dytën ofertë çmimi për këto punë është vendosur 22,396.00 euro, apo 14,678.00 euro më i lartë.

Mirëpo, problemi në mes të këtyre dy ofertave nuk qëndron në rritjen e çmimeve, por në problemet që ka pasur paramasa e ofertuar në rastin e parë, e të cilin komisioni i vlerësimit nuk e ka evidentuar si fakt që e bënë këtë GOE të papërgjegjshëm. Në paramasën e parë, operatori ekonomik nuk ka përfshirë në llogaritjen e totalit të kapitullit të dytë, shpenzimet për murin rrethues, për të cilin kishte planifikuar të shpenzonte 16,088.00 euro.

TABELA 26. Shpenzimet për murin rrethues të cilin GOE nuk e ka përfshirë në llogaritjen e shpenzimeve totale

Muret rrethuese të varrezave në fshatin Vragoc dhe Poqest 200 m2					16.088.0 EUR
PUNËT E MURIT RRETHUES					
4.1 Punët e dheut					
Gërmimi i dheut të kat. III- IV për themele shiritore dhe bartja e dheut të gërmuar deri në deponi.	m3	54	5.0 euro	270.00 euro	
Furnizimi dhe shtruarja e zhavorrit nën themele me trashësi 10.000cm pas ngjeshjes.	m3	6	8.0 euro	48.00 euro	
4.2 Punët e Themelit					
Furnizimi me material transporti dhe betonimi i themeleve me dimensione: 0.5*0.5*200.0m ³	m3	50	50.0 euro	2.500.00 euro	
Furnizimi me material, transporti dhe armimi i prerjes tërthore të trajeve të themeleve me armaturë gjatësore 6ø12	kg	1750	0.5 euro	875.00 euro	
Armatura e stafave: ø8/20cm ³	kg	750	0.6 euro	450.00 euro	

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Kapitulli i dytë i ofertës së parë ka pasur vlerë totale 7,718.00 euro siç edhe shihet në tabelën më lartë, mirëpo e njëjta do të duhej të kishte vlerën 23,806.00 euro duke përfshirë edhe shpenzimet për murin rrethues.

TABELA 27. Çmimet për pozicione dhe totali i kapitullit 2, duke mos përfshirë muret rrethuese

REKAPITULIMI – 2		
1	Inçizimet dhe punët paraprake në terren	170.00 euro
2	Pastrimi i terrenit dhe punët tokësore	288.00 euro
3	Konstruksioni i hapësirës	4,430.00 euro
4	Punët e fontanës dhe rregullimi i sendimentusit	750.00 euro
5	Gjelbërimi dhe këndi i lodrave	2,080.00 euro
GJITHSEJ 1+2+3+4+5		7,718.00 euro

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Siç shihet në këtë tabelë, muri nuk është vendosur në, siç është titulluar nga GOE, rikapitulimin 2, e as vlera prej 16,088.00 euro. Nëse një vlerë e tillë do të shtohet, atëherë kategoria dy do të kishte totalin prej 23,806.00 euro. Rrjedhimisht, vlera me të cilën GOE ka ofertuar me 53,034.00 euro ka qenë vlerë e pasaktë ngase ajo do të duhej të ishte 69,122.00 euro. Kjo do të thotë se oferta e dytë të jetë më e lirë se oferta e parë për 1,125 euro. Në ofertën e dytë është bërë evidentimi i murit rrethues dhe shpenzimet për të, ku në ofertën e dytë ky shërbim i ka kushtuar GOE-së 14,678.00 euro.

TABELA 28. Çmimet për pozicione dhe totali i kapitullit 2, duke përfshirë muret rrethuese

REKAPITULIMI – 2		
1	Inçizimet dhe punët paraprake në teren	170.00 euro
2	Pastrimi i terrenit dhe punët tokësore	288.00 euro
3	Konstruksioni i hapësirës	4,430.00 euro
4	Punët e fontanës dhe rregullimi i sendimentusit	750.00 euro
5	Gjelbërimi dhe këndi i lodrave dhe muri rrethues	16,758.00 euro
GJITHSEJ 1+2+3+4+5		22,396.00 euro

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Pavarësisht se muri rrethues është paraparë në kategorinë 4, shpenzimet për këtë punë janë bashkuar me ato të kategorisë 5. Gjelbërimi dhe këndi i lojërave në dy ofertat ka qenë 2,080.00 euro, ndërsa së bashku me shpenzimin për murin, për kategorinë 5 është llogaritur të shpenzohen 16,758.00 euro. Kjo situatë është evituar në rastin e dytë, ku edhe GOE është shpërblyer me kontratë. Por, kjo paramasë ka çështje të tjera të cilat komisioni vlerësues do të duhej t'i evidentonte dhe për të njëjtat komuna është dashur të kërkonte sqarime⁵² nga GOE në mënyrë që të sqarohet gjendja.

Fillimi i problemeve me paramasën ka filluar qysh kur e njëjta është hartuar nga komuna. Në paramasën për këtë tender, komuna në mënyrë shumë të përgjithësuar ka ndarë vetëm tri pozicione sipas vendeve kur do të kryhen punët. Mirëpo, nuk ka specifikuar se cilat punë duhet të kryhen. Se çfarë punësh duhet të kryhen, komuna ka mundur t'i paraqes saktësisht duke qenë se i ka të qarta nevojat e saj drejt rregullimit të këtyre hapësirave. Pra, në këtë rast komuna do të duhej të zgjeronte pozicionet dhe të specifikonte saktë se çfarë punë duhet të kryhen dhe këto përcaktime të mos i linte në diskrecion të OE-ve sepse kjo ka shkaktuar ngatërresa të shumta. Kjo ka lënë hapësirë që OE-të të përsërisin që të shtojnë punë që nuk janë të nevojshme por edhe punët e njëjta t'i vendosin në disa pozicione, e cila ka ndikuar që të vendosen çmime jo-normalisht të ulëta.

52 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 59, pika 2.

TABELA 29. Paramasa e hartuar nga komuna

LOT 1 – REKAPITULIMI	
1	Rregullimi i hapësirës publike në fshatin Gorazhdevc
2	Rregullimi i hapësirës publike në fshatin Llozhan dhe muret rrethuese të varrezave në fshatin Vragoc dhe Poqestë
3	Ndërtimi i ndriçimit publik në fshatrat: Poqest, Babiç, Millovanc dhe Vragoc
GJITHSEJ 1+2+3+4+5	

Burimi: Paramasa e hartuar nga AK

GOE për të bërë nivelizimin dhe ngjeshjen e nën-bazës së trupit të shëtitores dhe pjesëve për gjelbërim deri sa të arrihet ngjeshmëria 30-35 MPa, ka vendosur çmimin prej 0.1 cent për metër katrorë. Nga operatorët e tjerë ofertues, tre nga ta kanë ofertuar me çmime më të larta. Dy nga ta kanë ofertuar me 1.00 euro ndërsa tjetri me 0.50 cent, që i bije se çmimi prej 0.1 cent është shumë më i ulët. Jo vetëm në krahasim me ofertat e tjera, por edhe në aspektin praktik nuk ka mundësi që një punë e tillë të kryhet me këtë shumë.

TABELA 30. Pozicioni i paraqitur me çmimin 0.1 cent

Nivelizimi dhe ngjeshja e nën-bazës së trupit të shëtitores dhe pjesëve për gjelbërim deri sa të arrihet ngjeshmëria 30-35MPa	m2	320	0.1 euro	32.0 euro
---	----	-----	----------	-----------

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Në këtë situatë, kur një tender apo një pozicion duket se ka çmim jo-normalisht të ulët, autoriteti kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga OE një deklaratë e cila përfshinë të gjitha sqarimet e nevojshme për çmimin e ulët dhe këtë ta bëjë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP “Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët”⁵³. Fakti se një veprim i tillë nuk është ndërmarrë nga komuna në këtë rast, tregon se oferta nuk është vlerësuar me kujdes por edhe nuk janë ndërmarrë hapat e nevojshëm siç kërkon LPP.

Brenda kësaj paramase për punë të njëjta janë vendosur çmime të ndryshme. Në kategorinë e parë, rregullimi i hapësirës publike në fshatin Gorazhdevc, për mbjelljen e fidanëve, kufizimin e fidanëve me listela druri, ujitja dhe mirëmbajtja e tyre deri në nxënie për një copë është vendosur çmimi 30.00 euro. Ndërsa, për rregullimin e hapësirave publike në fshatin Llozhan për të njëjtën punë është vendosur çmimi 25.00 euro. Po ashtu, për furnizimin, transportimin dhe montimin e shportës për mbeturina në fshatin Gorazhdevc është vendosur çmimi për copë prej 45.00 euro. Për po të njëjtin pozicion, në fshatin Llozhan është vendosur çmimi prej 40.00 euro. Për punimin, transportin, montimin e ulëseve

⁵³ Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët, neni 4, pika 2.

në fshatin Gorazhdevc është vendosur çmimi prej 200 euro për copë, ndërsa për të njëjtat ulëse në fshatin Llozhan, është vendosur 250 euro për copë. Komuna edhe për këtë çështje do të duhej të ishte e kujdesshme dhe të sigurohej që ka informacionin e nevojshëm se pse është krijuar një situatë e tillë. Gjithsesi, meqenëse kemi të bëjmë me punë plotësisht të njëjta, çmimet nuk do të duhej të ndryshonin nga vendi në vend.

Krijimi i situatave të tilla vije sepse autoritetet kontraktuese lënë shumë hapësira të cilat përdoren nga operatorët ekonomikë. Nëse AK qysh në fillim do të kishte hartuar një paramasë precize, atëherë kjo do të lehtësonte punën e komisionit vlerësues por edhe OE-të nuk do të kishin mundësi që të ndërmarrin hapa të tillë dhe të manipulojnë me çmime nëpër pozicione të ndryshme. Po ashtu, nëse AK do të ishte më e kujdesshme në vlerësimin e ofertave, manipulime të tilla do të evitoheshin.

LOT 2 - Rregullimi i sheshit në f.sh Gorazhdevc, dhe ndriçimi publik në fshatrat Lozhan, Loxhë, Poqest dhe Vragoc - pjesa 2

Sikurse Lot 1, edhe Lot 2 është destinuar për kryerjen e punëve të njëjta në fshatrat e njëjtë. Ndryshe nga Lot 1, komuna në Lot 2 ka përcaktuar me saktësi nevojat e saj dhe çfarë është në interes të kësaj komune të rregullohen në këto hapësira. Mirëpo, nuk ka ndarë vendet se cili shërbim duhet të kryhet në cilin fshat.

Për Lot 2 janë ndarë 96,998.00 euro, ndërsa kanë ofertuar dhjetë OE me vlera të ndryshme të ofertave. Kontrata është lidhur me OE Mondri Sh.P.K. i cili ofertoj me vlerën prej 72,053.60 euro.

TABELA 31. Operatorët ofertues për Lot 2

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertës
1	MONDI Sh.P.K.	72,053.60 euro
2	GOE Termomontimi Sh.P.K. & Dino Sh.P.K.	78,895.00 euro
3	BM Group Sh.P.K.	85,774.00 euro
4	N.N. 100% Design Sh.P.K.	73,785.00 euro
5	GOE Engineering Group Sh.P.K. & Ridvan Elezi B.I.	86,644.50 euro
6	GOE N.M.I.Q. Montkomerce Sh.P.K. & Euroasphalt Sh.P.K.	92,780.00 euro
7	Sky Line Co Sh.P.K.	61,999.99 euro
8	GOE N.P.Sh. El-Ing & Asfalti Sh.P.K.	73,698.00 euro
9	Multi Business Group Sh.P.K.	88,927.28 euro
10	GOE BK- Construction Sh.P.K. & Ilir Lajçi B.I.	87,822.00 euro

Operatori ekonomik Sky Line Co Sh.P.K. kishte ofertuar më lirë, mirëpo i njëjti është përjashtuar nga ky aktivitet i prokurimit sepse nuk kishte plotësuar kërkesat që lidhen me stafin dhe me qarkullimin bankar. Por as OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar kërkesat që lidhen me stafin. Pra për të njëjtën arsye njëri është shpallur i papërgjegjshëm ndërsa tjetri fitues i kontratës.

Konkretisht, komuna ka kërkuar që OE të paraqes një listë të stafit me minimum 15 punëtorë të cilët do të angazhohen në ekzekutimin e kontratës, e për të njëjtit duhet të paraqiten parakontratat në emër të këtij projekti ose të paraqitet një listë nga ATK ku vërtetohet pagesa e kontributeve së paku gjashtë muajt e fundit. Nëse afati i fundit për dorëzim të ofertave ka qenë 28.06.2021, atëherë nënkuptohet se lista nga ATK duhet të dorëzohet e vitit 2021, nga janari deri në qershor. OE në ofertën e tij ka dorëzuar listën e ATK-së për vitin 2020 dhe atë për vetëm 12 punëtorë. Listës i janë bashkangjitur edhe disa punëtorë të tjerë por të cilët nuk figurojnë në listën e ATK-së e për të njëjtit as nuk është paraqitur ndonjë kontratë që dëshmon se ata punëtorë punojnë në këtë kompani ose janë të angazhuar në këtë projekt.

Kërkesë tjetër në dosjen e tenderit ka qenë që OE duhet të angazhoj tre inxhinierë si staf i lartë profesional. Njëri të caktohet si menaxher i projektit, dhe i njëjtë duhet të jetë inxhinier i ndërtimtarisë – konstruktiv. Për këtë inxhinier, kërkesa thotë që të ketë kontratë apo parakontratë në emër të projektit, mirëpo kontrata ose parakontrata nuk është dorëzuar, por është dorëzuar vetëm marrëveshja për angazhimin e tij si menaxher të projektit. Një nga tre inxhinierët duhet të jetë inxhinier i elektronikës i cili do të caktohet si udhëheqës i punishtes. I njëjti është caktuar udhëheqës i punishtes, por nuk është plotësuar në tërësi kërkesa sepse nuk është dorëzuar ndonjë kontratë apo parakontratë për këtë projekt.

Ndërsa, OE nuk ka angazhuar fare inxhinierin e tretë, rrjedhimisht për të njëjtit nuk ka dorëzuar asnjë dokument. Pra, janë kërkuar që të angazhohen tre inxhinier por realisht janë angazhuar vetëm dy.

Njësoj sikurse OE Sky Line Co Sh.P.K., edhe oferta e OE Mondit Sh.P.K do të duhej të cilësohej si e papërgjegjshme dhe të eliminohej. Në këtë rast, komuna ka vepruar kundërligjshëm, nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe nuk ka trajtuar të gjitha ofertat të barabarta kështu duke favorizuar disa nga to. Për më tepër, në paramasën që ka ofruar komuna në pozicionin 4 në të cilin përshkruhet blerja, bartja dhe montimi i llampave LED, në fund të tekstit kërkohet që ofertuesi për këto llampa të bashkëngjisë katalogun e llampës, ISO certifikatën e prodhuesit.

TABELA 32. Pozicioni 4 i paramasës për Lot 1 dhe 2

Pozicioni	Lot 1	Lot 2
Blerja, bartja dhe montimi i llampave LED	70.00 euro	18.00 euro

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Këto dokumente përveç se nuk janë dorëzuar, të njëjtat as nuk janë evidentuar nga komisioni vlerësues si mungesa në ofertën e operatorit ekonomik të shpërblyer me kontratë. Po ashtu, këto dy Lote do të duhej të ndaheshin në tema të ndryshme ngase punët nuk janë në të njëjtat vende. Në Lotin 1, sipas paramasave, punët janë kryer në fshatrat Gorazhdevc, Llozhan, Vrogoc dhe Poqest, ndërsa në Lotin 2, punët janë kryer në fshatin Loxhë. Një ndarje e tillë do të duhej të bëhej në mënyrë që të mos krijohet

konfuzion te operatorët ekonomikë. Dy paramasat e operatorëve fitues të Lot 1 dhe Lot 2, kanë përshkrime të pozicioneve të njëjta mirëpo çmimet ndërmjet tyre dallojnë shumë. Në paramasën për Lot 1, “blerja, barta dhe montimi i llampave LED” sikurse në tabelën 32, komunës në Lot 1 i kanë kushtuar 70.00 euro një copë, ndërsa e njëjta llampë , për Lot 2 i ka kushtuar 18.00 euro, apo 52 euro më lirë.

Pra, dallimi i vetëm në mes të dy llampave është se llampa në Lot 1 ka qenë 63-50 W, ndërsa ajo e Lot 2 63-80 W. Njësoj edhe me furnizimin dhe vendosjen e shtyllave të betonit me gjatësi 10 metra, në të njëjtin tender në Lot 1 ka kushtuar 70.00 euro ndërsa në Lot 2 ka kushtuar 150.00 euro, apo 80.00 euro më shtrenjtë. Në këtë rast komuna do të duhej t'i kushtonte më shumë rëndësi çmimeve nëpër pozicione, kjo duke pasur parasysh se kemi pasur të bëjmë me punë të ngjashme dhe me të njëjtit aktivitet të prokurimit.

Blerja e moto kultivatorëve

Komuna e Pejës në maj të vitit 2022, hapi tenderin për blerjen e moto kultivatorëve në vlerë të parashikuar të kontratës 157,500.00 euro. Ky tender kishte për qëllim blerjen e 150 moto kultivatorëve dhe realizohej në partneritet me fermerët, ku komuna do të financonte 60% të shumës ndërkohë pjesa tjetër do mbulohej nga fermerët.

Në këtë aktivitet të prokurimit morën pjesë pesë (5) operatorë ekonomikë, tekta procesi u karakterizua nga ankesa të shumta të cilat erdhën si rezultat i gabimeve në përcaktimin e kriterëve në Dosjen e Tenderit.

TABELA 33. Operatorët ekonomikë të cilët morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit publik

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Shuma totale e ofertës
1.	N.P.T Haxhijaha Sh.P.K.	126,600.00 euro
2.	Komtel Project Engineering Sh.P.K.	157,200.00 euro
3.	N.P.T Bajra	157,200.00 euro
4.	Agri Bau Sh.P.K	84,000.00 euro
5.	Ana Co Sh.P.K	116,550.00 euro

Komuna e Pejës fillimisht ndryshoi paramasën duke larguar fjalët “prodhime evropiane...”, për të mundësuar pjesëmarrjen edhe të prodhuesve të tjerë të cilët përmbajnë certifikatat e kërkuara sipas standardeve të BE-së. Ky ndryshim ishte i rëndësishëm pasi kontrata iu dha më pastaj pikërisht një operatorit ekonomik që ofertoj me produkte të prodhuara jashtë Evropës (në Kinë).

Pas ankesave të operatorëve ekonomikë, komuna ndryshoi përsëri paramasën e tenderit, duke shtuar fjalën “ose ekuivalent” te specifikimet teknike, ku ndonëse nuk specifikohet emri i një prodhuesi, operatorët ekonomikë pretendonin se standardi i kërkuar (fuqia: minimum 7.1 – maksimum 8.0 HP, 252 cm3), ishte i veçantë vetëm për prodhuesin STIHL (MH700).

Komuna rekomandoi për kontratë operatorin ekonomik, Agri Bau Sh.P.K., që kishte ofertuar me 84,000.00 euro, shumë kjo që ishte 46% më pak se vlera e parashikuar e kontratës. Katër operatorët e tjerë ekonomikë që morën pjesë në këtë tender u eliminuan me arsyetimin se nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara nga komuna. Megjithatë, edhe Agri Bau Sh.P.K., me të cilin komuna nënshkroi kontratë me 9 dhjetor të vitit 2022, nuk plotësonte kërkesat e tenderit.

Në Dosjen e Tenderit kërkohej që ofertuesit të prezantonin certifikatat ITAF 16949:2016 dhe ISO 5001:2018. Agri Bau Sh.P.K., dorëzoi katër ISO certifikata por asnjëra prej tyre nuk ishte kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, ky operator ekonomik nuk ofroi dëshmi për një numër kriteresh të përcaktuar në specifikimet teknike. Në katalogun e prezantuar të ofertën e Agri Bau Sh.P.K., nuk figurojnë fare të dhënat për disa kriteret teknike si: moto kultivatorët të jenë me dy rrota, rrota pneumatike, timoni i palosshëm, përshtatja qendrore e timonit deri në 180 shkallë, etj.

Pikërisht për këtë arsye, komuna eliminoi katër operatorët e tjerë ekonomikë, duke thënë se katalogët broshura të produkteve të këtyre operatorëve ekonomikë nuk plotësonin kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit.

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë/broshura për produkte të ofruara duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike”.

Komuna e Pejës në këtë rast ka përdorur standard të dyfishtë duke eliminuar katër operatorë ekonomikë për katalogët e prezantuar, ndërkohë që ka shpërblyer me kontratë Agri Bau Sh.P.K., që nuk kishte ofruar përshkrime në katalog për një numër të karakteristikave të produktit siç kërkohej në Dosjen e Tenderit. Në bazë të analizimit të ofertave, të paktën dy operatorë ekonomikë (Komtel Project Engineering Sh.P.K dhe Haxhijaha Sh.P.K) kanë prezantuar broshura që përshkruanin llojin dhe karakteristikat e produktit që ofronin dhe të njëjtat duhej të ishin pranuar nga komuna.

Pranimi i këtyre dy ofertave do të prodhonte një situatë të re, ku çmimi i ofruar nga operatori ekonomik fitues do të ishte jo normalisht i ulët (çmimi i ofruar nga Agri Bau Sh.P.K. do ishte 31% më i ulët se çmimi mestar i ofruar dhe 33% më i ulët se çmimi i dytë më i ulët i ofruar⁵⁴). Në këtë situatë, komuna do duhej të kërkonte shpjegime shtesë në lidhje me çmimin jo normalisht të ulët dhe në qoftë se shpjegimi nuk do të arsyetonte çmimin e ofruar, atëherë komuna do duhej të eliminonte në tersi këtë ofertues.

Po ashtu, në Dosje të Tenderit, konkretisht në pjesën III të kontratës “kushtet e veçanta” specifikohet që dërgesa e mallit nga furnizuesi do të bëhet brenda 5 ditëve pas marrjes së “urdhër blerjes”, por në deklaratën e liferimit të Agri Bau Sh.P.K., nuk përmendet askund afati prej 5 ditëve. Aty thuhet vetëm se “artikujt në listën e çmimeve do të liferohen në afat maksimal prej 120 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës dhe urdhrit të blerjes”.

Deklarata e liferimit është në kundërshtim me kushtet e Dosjes së Tenderit, duke qenë se ofron një afat maksimal për furnizim 120 ditë, i cili nuk i përmbahet afatit prej 5 ditëve të përcaktuar në kushtet e veçantat të kontratës.

54 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullorja B57 për çmime jo normalisht të ulëta.

Ndërtimi i hapësirave publike përreth QKMF-së

Komuna e Pejës ka lidhur kontratë me qëllim të ndërtimit të hapësirave publike rreth QKMF-ve, ku më saktësisht punët që do të kryhen kanë të bëjnë me incizimet dhe punët paraprake në teren, pastrim i terrenit dhe punët tokësore, konstruksioni i hapësirës, gjelbërimi dhe punët elektrike. Për këtë kontratë kanë ofertuar tre operatorë ekonomikë, ndërsa me kontratë është shpërblyer GOE VB. Tofaj & PE-VLA-KU Sh.P.K., me ofertën në vlerë prej 95,365.00 euro.

TABELA 34. Ofertat e operatorëve ekonomikë për këtë kontratë

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta
1	GOE VB. Tofaj & PE-VLA-KU Sh.P.K.	95,365.00 euro
2	Mondi Sh.P.K.	89,562.50 euro
3	GOE BK-Construction Sh.P.K. & Ilir Lajçi B.I.	92,772.00 euro

Operatori tjetër, GOE BK-Construction Sh.P.K. & Ilir Lajçi B.I. kishte ofertuar me çmim më të ulët, mirëpo nuk ishte shpallur fitues sepse komuna e kishte shpallur fitues këtë GOE për Lot 1, të cilën më vonë e anuloi. Pra, për këtë Lot, komuna në njoftimin për vendim nuk ka potencuar se ky GOE ka pasur ndonjë problem tjetër sa i përket kërkesave në dosjen e tenderit, por nuk është shpallur fitues sepse në dosje të tenderit është përcaktuar që një OE ka të drejtë të shpërblehet me vetëm një Lot.

Ndërmarrja e veprimeve të gabuara nga ana e komunës ka shkaktuar problematika zingjirore, kështu duke dëmtuar ofertuesit dhe duke eliminuar të njëjtin pa të drejtë nga gara. Sipas dosjes së tenderit, kohëzgjatja e Loteve është përcaktuar të jetë 90 ditë, ndërsa në kontratën e lidhur në mes të palëve kontraktuese, te kushtet e veçanta të kontratës potencohet se përfundimi i të gjitha punëve do të bëhet brenda 60 ditë pune. Përderisa kushtet e veçanta mbizotërojnë ato të përgjithshmet, atëherë si afat për përfundimin e punëve duhet të merren 60 ditë. Po ashtu, në këtë pjesë të kontratës thuhet se punët do të fillojnë pesë ditë pas nënshkrimit të kontratës, që i bje se nëse kontrata është nënshkruar më 15.07.2021, punët duhet të fillojnë me 20.07.2021. Rrjedhimisht, punët të përfundojnë rreth muajit shtator ose tetor të vitit 2021.

Bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion nga komuna e Pejës për këtë tender⁵⁵, shohim se menaxheri i kontratës ka nënshkruar dokumentin i cili njofton për përfundimin e punëve për këtë kontratë dhe i njëjti mbanë datën 12.08.2022. Në një dokument tjetër i cili mbanë po të njëjtën datë, pra 12.08.2022, menaxheri i kontratës ka deklaruar mbi arsyeshmërinë e tejkalimit të planit dinamik, duke sqaruar se është tejkaluar plani dinamik për arsye të komunikacionit të stërngarkuar motorik dhe i njëjti ka deklaruar se e arsyeton një veprim të tillë për shkak të kësaj arsyeje.

Mirëpo, në mes të kohës kur është planifikuar të përfundohen punët për këtë tender dhe datës kur një arsyetim i tillë është dhënë, dhe kur është njoftuar për përfundim të punëve, janë më shumë se dhjetë

⁵⁵ Dokumentet e marra pas paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente publike, të bërë me datë 26.08.2022.

muaj, thuajse një vit. Kjo nënkupton se puna e planifikuar të përfundohet brenda 60 ditë pune nuk është përfunduar për gati një vit. Madje, në bazë të dokumenteve që komuna ka vënë në dispozicion, shohim se njoftime të tilla për vonesa në ekzekutim të kontratës nuk ka pasur. Kjo cila tregon se menaxheri i kontratës nuk ka raportuar saktësisht mbi atë se çfarë po ndodhë realisht me zbatimin e kontratës.

Në kontratën e lidhur në mes OE dhe komunës janë përcaktuar shumë qartë shkeljet e kontratës dhe shkeljet e kontratës. Neni 36 i kontratës thotë se pala shkelë kontratën kur nuk arrin të shlyej obligimet e saj që dalin nga kontrata, dhe si rezultat në nenin 36.2, pika b, thotë se kur ndodhin shkelje të tilla, pala e dëmtuar mund të ndërpres kontratën. Në këtë rast pala e dëmtuar ka qenë institucioni, sepse projekti nuk është arritur të realizohet në kohën e paraparë ku çdo vonesë ndikon në aqytetarët e kësaj komune e veçanërisht si në këtë rast kur kemi të bëjmë me ambientet rreth QKMF-së e cila ka frekuentim të madh.

Autoritetet kontraktuese duhet të përdorin dispozita të tilla, e në disa raste të ndërpresin kontratat, kjo në mënyrë që të bëhet disiplinimi i operatorëve ekonomikë. Mirëpo, për të arritur deri në këtë pikë duhet që menaxheri i kontratës të kryej me përgjegjësi punës e tij dhe kurdo që has në vonesa të paarsyeshme t'i rekomandoj Zyrës së Prokurimit ndërprerjen e kontratës ose marrjen e masave të tjera të parapara me LPP dhe akte nënligjore. Meqenëse me 12.08.2022 është dorëzuar njoftimi për certifikatën e përfundimit të punëve, atëherë kuptojmë se kontrata e fundit nga operatori te komuna është dorëzuar më datë 15.08.2022, në vlerë prej 43,888.50 euro, ndërsa urdhër pagesa për këto shërbime është bërë më 06.09.2022. Kjo faturë njëkohësisht është fatura e vetme në të cilën komuna ka lejuar qasje, prandaj edhe nuk është e qartë se nëse një kontratë e tillë është përmbushur plotësisht, apo nga 95,365.00 euro sa kishte vlerë kontrata janë shpenzuar vetëm 43,888.50 eurot e paguara.

Situatën më të vështirë për autoritetin e bënë fakti se në faturë nuk evidentohen saktë se cilat produkte janë blerë, çfarë punësh janë kryer dhe në çfarë sasive. Por në vend se të qartësoheshin blerjet dhe punët, operatori ekonomik në përshkrim të faturës përdorë emrin e kontratës, ndërsa vendosë një vlerë monetare të shpenzuar me të cilën nuk kuptohet çfarë ka blerë dhe çfarë ka punuar.

TABELA 35. Fatura e OE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Totali i kontratës	Vlera e përfshirë dhe TVSh
1	Ndriçimi dhe kubëzimi i hapësirave publike në Komunën e Pejës – Pjesa II Lot 3- Ndërtimi i hapësirave publike përreth QKMF-së	Përqindja	88.00%	95,365.00€	43,888.50€

Burimi: Oferta e operatorit ekonomik

Fatura si në tabelën më lartë është e paqartë, përveç se komuna obligohet të paguaj këtë shumë. Një praktikë e tillë duhet të ndalohet ngase AK duhet të dijë me saktësi nëse janë blerë ato produkte ose janë kryer ato punë, dhe nëse të njëjtat kanë të njëjtin çmim sikurse në paramasë. Një tolerim i tillë krijon mundësinë që OE-të të manipulojnë me çmime dhe me sasi të produkteve apo të punëve të kryera.

Në paramasë janë paraparë edhe punët e elektrikes, ku në pozicionin 5.7 kërkohet të bëhet furnizimi dhe montimi i llampave për ndriçim, ku në po të njëjtin pozicion theksohet se për këto llampa ofertuesi duhet të bashkëngjijt në ofertën e tij katalogun e llampës duke e nënvizuar tipin e ofruar dhe ISO standardin e prodhuesit. Pavarësisht se një kërkesë e tillë nuk është kërkuar në dosje të tenderit, nuk e bënë këtë kërkesë në paramasë më pak obligative për tu përmbushur. Prandaj, autoriteti kontraktuese duhet të vlerësoj me kujdes çdo dokument të tenderit dhe të vendosë që një kërkesë të tillë ose ta vlerësoj së bashku me kërkesat e tjera ose ta largoj në tërësi ngase duhet eliminuar çdo mundësi që mund të ndikoj në krijimin e standardeve të dyfishta në vlerësimin e ofertave të operatorëve.

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në komunë

Komuna e Pejës në prill të vitit 2022 hapi tenderin për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve, me vlerë të parashikuar të kontratës prej 74,000.00 euro për 24 muaj. Tenderi kishte për qëllim dhe planifikonte furnizimin dhe realizimin e vijave të ndërprera, vijave të plota në mesin e rrugës, realizimin e një vendkalimi të këmbësorëve, vendosjen e shigjetave të ndryshme që tregojnë drejtimin dhe montimin e barrierave horizontale në rrugë.

Në këtë aktivitet të prokurimit morën pjesë shtatë operatorë ekonomikë, derisa me kontratë u shpërblye kompania ER – Lis Sh.P.K., si tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

TABELA 36. Operatorët ekonomikë që morën pjesë në këtë aktivitet të prokurimit publik

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Lindi Markings Sh.P.K.	52,490.00 euro
2.	Er – Lis Sh.P.K.	41,515.00 euro
3.	N.Sh. Liriu	73,800.00 euro
4.	RSM Company Sh.P.K.	63,750.00 euro
5.	Limit L & B Sh.P.K.	51,000.00 euro
6.	Sinjalizimi Sh.P.K	49,895.00 euro
7.	I.T.K Sh.P.K	52,945.00 euro

Megjithatë, edhe operatori ekonomik të cilën komisioni vlerësues e rekomandoi për kontratë, nuk kishte plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe komuna e Pejës bëri disa gabime gjatë vlerësimit të ofertave.

Fillimisht, operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë nuk prezantoi dëshmi të librezës së qarkullimit ose DUD doganorë, fatura për blerje ose për qiramarrje, që do të vërtetonin pronësinë e pajisjeve të kërkuara në dosjen e tenderit. Gjithashtu, në ofertën e Er Lis Sh.P.K., nuk figuron asnjë katalog lidhur me sinjalizimin vertikal, por është prezantuar vetëm një deklaratë për specifikacionin teknik.

Kontrata e prezantuar për shfrytëzimin e makinerisë për këtë aktivitet të prokurimit, e lidhur mes operatorit ekonomik fitues dhe kompanisë VE More Sh.P.K., nuk përmban datë, dhe nuk dihet se kur ka

filluar apo kur do të përfundojë. Në këtë situatë, komisioni vlerësues është i obliguar që sipas nenit 39 të RrUOPP, të kërkoj sqarime shtesë për këto dokumente të cilat nuk figuronin në ofertën e operatorit ekonomik fitues. Përveç kësaj, komisioni vlerësues nuk vërejtë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dukej të ishte jo normalisht e ulët⁵⁶, me që rast ishin plotësuar kushtet dhe komuna do duhej të kërkonte shpjegime shtesë se si ishin arritur këto çmime.

Komuna e Pejës shkeli LPP-në edhe me rastin e hedhjes poshtë të kërkesës për rishqyrtim të Lindi Markings Sh.P.K., të cilën e trajtoi si jashtë afatit. Komuna publikoi – Njoftimin mbi vendimin nga AK me datë 20.05.2022, ndërkohë operatori ekonomik ankues parashtrori kërkesën për rishqyrtim me datën 25.05.2022, pra pesë ditë më vonë. Komuna e Pejës veproi në kundërshtim me LPP⁵⁷ pasi shkeljet e supozuara që kanë të bëjnë me vendimin për dhënien e kontratës, mund të bëhen në afat prej 5 ditëve, pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës, ku dita e publikimit të njoftimit llogaritet si dita 0, pra janë edhe 5 ditë nga kjo ditë.

56 Sipas nenit 3 të B57 Rregullat për Tenderët Jo Normalisht të Ulët.

57 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurimin Publik. Neni 108/A paragrafi 3, pika 3.2.

Rekomandime

- Institucione publike të cilat lidhin kontrata me operatorët ekonomikë, të sigurojnë konkurrencën në çdo aktivitet të prokurimit në mënyrë që të bëhet përdorimi më ekonomik i parasë publike.
- Institucionet publike të vlerësojnë drejtë dhe me përgjegjësi ofertat e operatorëve ekonomikë, të cilët do t'i shpërblejnë me kontratë në mënyrë që të realizohen kërkesat e projektit dhe të arrihet vlera për parane.
- Kurdo që këto institucione thirren në një dispozitë të caktuar për të marrë një vendim, të respektojnë dhe të veprojnë konform asaj dispozite në tërësi.
- Gjatë hartimit të kërkesave në dosje të tenderit dhe në paramasë, institucionet të përcaktojnë qartë nevojat e veta dhe të evitohet çdo zbrazëti në mënyrë që të eliminohen mundësitë për manipulim dhe keqpërdorim.
- Institucionet publike të mos pranojnë fatura nga operatorët ekonomikë në të cilat nuk specifikohen saktë sasi dhe çmimet për produktet e blera, punët e kryera dhe furnizimet e realizuara. Kjo edhe në mënyrë që të mos lejohet shmangia nga çmimet e vendosura në paramasë.
- Të respektohet dhe zbatohen me saktësi plani vjetor i prokurimit.

Komuna e Gjakovës

- Të evitohet vendosjen e ISO standardeve të cilat kufizojnë konkurrencën.
- Në mënyrë që të mos vije deri te anulimi i njoftimit për kontratë por edhe të shpërblimi me kontratë i një operatori të papërgjegjshëm, të vlerësoj me korrektësi ofertat e operatorëve dhe të ndërmarrë hapat ligjorë të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të prokurimit.

Komuna e Prishtinës

- Të evitohet në çdo situatë vazhdimin e kontratave të cilat më nuk i shërbejnë interesit publik.
- Të shmangë përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë kur nuk ekzistojnë rrethana që detyrojnë përdorimin e kësaj procedure.
- Të mos anashkaloj shkelje ligjore të cilat janë lehtë të evitueshme.

Komuna e Prizrenit

- Të mos lidhë kontrata me operatorë ekonomikë që nuk janë kompetent në kryerjen e punëve që kërkohen nga projekti.
- Të shfrytëzoj të gjitha të drejtat që i garantohen me Ligjin për Prokurimin Publik në mënyrë që të sigurohet se gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit respektohet në tërësi Ligji për Prokurimin Publik dhe kështu të lidhen kontrata me operatorë ekonomikë të përgjegjshëm.

Komuna e Gjilanit

- Të zbatoj planin vjetor të prokurimit në mënyrë që të realizohen të gjitha projektet e parapara në atë vit.
- Gjatë zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik, të siguroj që nuk po vepron në kundërshtim me ligje të tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Të evitoj shkurtimin e afateve kohore për dorëzim të ofertave pa ndonjë arsye që mbështetet në ligj.

Komuna e Pejës

- Të siguroj se ka kontakte të vazhdueshme me menaxherët e kontratave në mënyrë që të evidentohet çdo parregullsi dhe ndaj tyre të merren masa konform Ligjit për Prokurimin Publik.
- Të vlerësoj me saktësi ofertat e operatorëve ekonomikë dhe për të njëjtët të mos përdorë standarde të dyfishta të vlerësimit.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

